

Në bazë të nenit 7, nenit 12 paragrafi (6), nenit 13 paragrafi (3), nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 10, neni 20 paragrafi (1) nënparagrafi 4 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18,dhe 27/16), dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr.42/20, 77/21, 154/23, 55/24 dhe 193/24), dhe në lidhje me nenin 152 paragrafi (7) nga Ligji i njëjtë, në përputhje me Konkluzionin e Këshillit të Agjencisë, nr.02-3580/2 datë 21.8.2025, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, në seancën e 8-të të mbajtur më 21.8.2025, miratoi:

RREGULLORE E PUNËS SË AGJENCISË PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZIVE

I.Dispozita të përgjithshme

Neni 1

Kjo Rregullore e Punës rregullon punën e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive (në tekstin e mëtejshëm: Agjencia).

Rregullorja e Punës së Agjencisë rregullon: fushëveprimin e punës, kompetencën, përgjegjësinë për punën e Agjencisë, organet e Agjencisë, llogon, përpunimi dhe përdorimi i vulave të Agjencisë, mënyra dhe procedura e mbajtjes së seancave të Agjencisë, (në tekstin e mëposhtëm Këshilli): mbledhjet publike, procedura për zgjidhjen dhe shkarkimin e drejtorit dhe zëvendësin e drejtorit të Agjencisë, procedurën për emërim dhe shkarkim të drejtorit dhe zëvendësit të drejtorit të Agjencisë, procedurën për miratimin e akteve nënligjore, dhe akteve të tjera të paraqitura në Ligjin për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (në tekstin e mëposhtëm: LSHMAAV), mënyrën dhe procedurën e dhënies, marrjes ose vazhdimin e lejes për transmetim televiziv ose radio, mbrojtja e pluralizmit dhe diversitetit të shërbimeve mediatike audio dhe audiovizuale, ritransmetimin e shërbimeve programore nëpërmjet rrjeteve publike të komunikimit elektronik, monitorimi i punës së ofruesve të shërbimeve mediatike audiovizuale me kërkesë, ofruesit e shërbimeve të platformës për ndarjen e videove, personat fizik që janë ofrues të shërbimeve mediatike audiovizuale me kërkesë – influencers/vlogerë dhe mediave online – internet portalet; mbikëqyrjen dhe masat për shkelje të rregullave, mënyrën dhe procedurën e udhëheqjes së regjistrave të përcaktuar me LSHMAAV dhe LM dhe dispozita të tjera me rëndësi për punën e Agjencisë.

Neni 2

Agjencioni për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive është trup rregullator i pavarur dhe i mëvetshëm jofitimprurës me status të personit juridik me autorizime publike.

Republika e Maqedonis së Veriut është themeluesi i Agjencisë.

Prona dhe mjetet e punës së Agjencisë përdoren dhe menaxhohen nga vetë Agjencia. Selia e Agjencisë është në Shkup.

Neni 3

Agjencia ka vulën/ shtembill (pullë) në formë të rrumbullakët dhe vulë/shtembill pranues dhe dalës në formë drejtkëndëshe. Përdorimi i vulës/shtembilli të rrumbullakët mund të jetë në formë fizike, dhe përdorimi i vulës/shtembilli pranues dhe dalës mund të jetë në formë fizike ose elektronike, në përputhje me Ligjin për dokumente elektronike, identifikimit elektronik dhe shërbimeve të besueshme.

Vula/shtembilli i Agjencisë është në formë të rrumbullakët. Në mes të vulës/shtembillit është stema e Republikës së Maqedonis së Veriut, dhe përreth saj në formë gjysmërrethi në gjuhën Maqedone dhe alfabetin e saj kilirik, si dhe gjuhën që e flasin së paku

20% e qytetarëve dhe gjuhës së saj është shkruar: "Republika e Maqedonisë së Veriut - Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive – Shkup

Vula pranuese e Agjencionit ka formë drejtëkëndëshe, dhe mbi të në gjuhën Maqedone dhe shkrimin kiril, si dhe në gjuhën që e flasin 20% e qytetarëve është shkruar: "Република Северна Македонија - Агенција за аудио и аудиовизуелни медиумски услуги- Скопје / Republika e Maqedonisë së Veriut – Agjencia për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele - Shkup".

Vula dalëse/shtembilli i Agjencisë ka formë drejtëkëndëshi, në të cilën gjendet stema e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe në gjuhën Maqedone dhe alfabetin e saj kirilik, si dhe në gjuhën që e flasin së paku 20% e qytetarëve dhe shkrimin e saj është shkruar: "Република Северна Македонија – Агенција за аудио и аудиовизуелни медиумски услуги – Скопје/ Republika e Maqedonisë së Veriut – Agjencia për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele – Shkup", me vënd për shtimin e numrit të arkivit dhe datën e çertifikimit të dokumentit.

Vula pranuese/shtembilli i Agjencisë ka formë drejtëkëndëshe, dhe në të në gjuhën maqedonase dhe shkrimin kirilik, si dhe në gjuhët që e flasin së paku 20% e qytetarëve dhe shkrimin e saj është shkruar: "Република Северна Македонија – Агенција за аудио и аудиовизуелни медиумски услуги – Скопје / Republika e Maqedonisë së Veriut – Agjencia për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele – Shkup", me vend për shtimin e datës së pranimit, njësinë organizative, numrin, bashkëngjitjen dhe vlerën.

Vula/shtembilli, pranues dhe dalës dhe vula/shtembilli vihen në aktet që miratohen nga Këshilli i Agjencisë, si dhe në aktet që miratohen nga drejtori ose zëvendësi i drejtorit të Agjencisë, në përputhje me Dekretin e punës zyrtare dhe arkivin. Me akt të miratuar nga drejtori/zëvendësi i drejtorit të Agjencisë, rregullohet mënyra e përdorimit të vulave/shtembillit dhe përcaktohen personat të cilët operojnë dhe i ruajnë ato.

Neni 4

Agjencia ka shenjën e saj mbrojtëse (logon).

Shenja mbrojtëse (logoja) e Agjencisë dhe mënyra e përdorimit të saj janë përcaktuar me vendim të Këshillit të Agjencisë.

Neni 5

Emri i plotë i Agjencisë është "Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele" Emri i shkurtuar i Agjencisë është: "ASHMA".

II.FUSHËVEPRIMI I PUNËS DHE KOMPETENCAT E AGJENCISË

Neni 6

Agjencioni në punën e saj angazhohet për: zhvillimin e agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele, promovimin e lirisë së fjalës, zhvillimin e produksionit të pavarur, nxitjen, zhvillimin dhe mbrojtjen e identiteti kulturor, gjuhën dhe traditat e bashkësisë në Republikën e Maqedonisë së Veriut, respektimin e kulturave dhe dallimeve të religjioneve, ngritjen e kulturës dhe dialogut ndërmjet qytetarëve me qëllim të forcimit të mirëkuptimi të ndërsjelltë dhe tolerim për ecjen përpara të marrëdhënieve ndërmjet bashkësive të ndryshme, inkurajim të kreativitetit, zhvillimin arsimor dhe studimor, mbrojtjen e interesave të përdoruesve, në veçanti të të miturve, zhvillimin e arsimit mediatik, transparencë, pavarësi, dhe shërbim publik radiodifuziv efikas për kryerje transparente, të pavarur, efikase të kompetencave të saj si trup rregullator në fushën e shërbimeve mediatike audio dhe audiovizuele, për zhvillim teknik-teknologjik të shërbimeve mediatike audio dhe audiovizuele, konvergjencë me komunikimet komerciale dhe shërbimet e shoqërisë së informacionit, nxitjen

dhe zhvillimin e konkurrencës të shërbimeve mediatike audio dhe audiovizuele dhe ritransmetimin e shërbimeve programore nëpërmjet rrjeteve publike të komunikimit elektronik dhe zhvillim të ekonomisë në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Neni 7

Agjencioni në përputhje me Ligjin për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele:

- kujdeset për ofrimin e publikimit në punën e transmetuesve,
- inkurajon lirinë e shprehjes,
- kujdeset për mbrojtjen dhe zhvillimin e pluralizmit të mediave audio dhe audiovizuele, inkurajon dhe mbështet ekzistencën e shërbimeve të larmishme, të pavarur dhe të mëvetësuar të shërbimeve mediatike audiovizuele,
- ndërmerr masa në përputhje me LSHMAAV dhe Ligjin për media (në tekstin e mëposhtëm: LM) në rast nëse paraqitet shkelje e dispozitave të Ligjit ose të dispozitave të miratuara në bazë të tyre dhe kushteve dhe detyrimeve të lejeve,
- kujdeset për mbrojtjen e të drejtave të të miturve,
- miraton aktet që dalin nga LSHMAAV dhe LM,
- angazhohet për mbrojtjen e interesave të qytetarëve në aspekt të shërbimeve mediatike audio dhe audiovizuele, si dhe për vlerësimin e masave për mbrojtjen e këtyre interesave të aplikuar nga shërbimet e platformave të ndarjes së videove,
- konstaton ekzistencën e palejuar të koncentrimit mediatik,
- vendos për ndarjen, marrjen ose vazhdimin e lejes për transmetimet televizive ose në radio,
- ndërmerr masa për kufizim të kohës së transmetimit dhe ritransmetimit të shërbimeve mediatike audio dhe audiovizuele nga të tjera shtete në Republikën e Maqedonisë së Veriut në përputhje me nenin 45 të LSHMAAV,
- sjell listë të eventeve më të rëndësishme për publikun e Republikës së Maqedonisë së Veriut,
- inkurajon arsimim mediatik,
- kryen mbikëqyrje në përputhje me nenet 28, 29, 30 nga LSHMAAV dhe nenit 29 të LM,
- udhëheq regjistrat të përcaktuar nga LSHMAAV dhe LM,
- realizon kërkime dhe analiza në lidhje me çështje të caktuara në fushën e shërbimeve mediatike audio dhe audiovizuele,
- kryen dhe punë të tjera të përcaktuara me këto ligje.

Neni 8

Agjencia në punën e saj angazhohet për arritjen e objektivave të përcaktuara në nenin 2 të LSHMAAV dhe është e pavarur nga çdo organ tjetër shtetëror ose person juridik dhe duhet të jetë e paanshme ndaj tyre.

Agjencia kryen punët në përputhje me Ligjin për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele dhe dispozitat e miratuara në bazë të tij, Ligjit për media, Ligjit për Procedurë të Përgjithëshme Administrative, nëse në ligjin e Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele nuk është paraparë ndryshe, ligjet e tjera dhe dokumentet strategjike të Republikës së Maqedonisë së Veriut, si dhe marrëveshjet ndërkombëtare në fushën e medias dhe shërbimeve mediatike audiovizuele të nënshkruara ose të aderuar nga Republika e Maqedonisë së Veriut.

Neni 9

Puna e Agjencisë financohet nga fondet e realizuara nga Buzheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut, nga të ardhurat e kompensimeve të parashikuara nga LSHMAAV, si dhe nga huatë dhe të tjera ndihma financiare dhe teknike.

Agjencia ka llogaritë e saj bankare në bankat komerciale në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Neni10

Për realizimin e të drejtave, obligimeve dhe përgjegjësit të përcaktuara me ligj, Agjencia nëpërmjet organeve të saj (drejtorit dhe këshillit të Agjencisë) miraton rregullore, udhëzime, vendime, aktvendime, konkluzione, programe, politika, metodologji, si dhe përcakton qëndrime dhe propozime për zbatimin e LSHMAAV dhe LM.

Rregullorja përpunon disa dispozita të caktuara të LSHMAAV dhe LM.

Udhëzimi përshkruan mënyrën e veprimit në kryerjen e dispozitave të caktuara të LSHMAAV dhe LM, aktet nënligjore dhe rregulloret e tjera të miratuara në bazë të Ligjit.

Me vendim miratohet për: shpalljen e konkursit publik për dhënien e lejes për transmetim televiziv dhe radio; dhënien, heqjen ose vazhdimin e lejes për transmetim televiziv dhe radio; lejimin përkatës të ndalimit të ndryshimit në strukturën e pronësisë të transmetuesit; anulimin e vendimit me të cilën lejohet zbatimi i ndryshimit në strukturën e pronësisë; iniciimin e procedurës për konstatim të ekzistimit të koncentrimit të palejuar mediatik, sipas detyrës zyrtare; konstatim të ekzistencës së koncentrimit të palejuar mediatik; çështje në lidhje me identifikimin dhe regjistrimin e shërbimeve të platformës të ndarjes së videoeve dhe për kërkesat që duhet t'i plotëson si (publikim impresium, detyrimet e tyre, masat për të siguruar respektimin e detyrimeve dhe çështje në lidhje me zgjidhjen e kontestit); për përcaktimin e listës së eventeve (kombëtare ose ndërkombëtare) me rëndësi të veçantë për publikun e RMV; për shkarkimin e drejtorit /zëvendësit të drejtorit të Agjencisë; refuzimin e kërkesës me shkrim nga palë e innteresuar për dhënien e lejes për transmetim televiziv dhe radio nëse konstatohet se nuk ka frekuencë të lirë ose kapacitete; refuzim të kërkesës për vazhdimin e lejes nëse transmetuesi ka kryer shkelje serioze gjatë kohëzgjatjes së lejes si dhe për çështje të tjera në kompetencë të saj;

Aktvendimi paralajmëron botuesit e medias, ofruesit e shërbimeve audiovizuale me kërkesë dhe ofruesit e shërbimit të platformës të ndarjes së videoeve dhe operatorët e rrjeteve publike të komunukimit elektronik nëse konstatohet mosrespektim, cënim ose shkelje e dispozitave të LSHMAAV dhe LM, akteve nënligjore të miratuara në bazë të ligjit, si dhe të kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara në leje dhe akte të tjera të Agjencisë; vendos për fshirjen nga regjistri në përputhje me LSHMAAV dhe LM; për kompensim vjetor të mbikëqyrjes për operatorë të rrjeteve publike të komunikimeve elektronike, ofrues të shërbimeve mediatike audiovizuale me kërkesë dhe ofrues të shërbimit të platformës për ndarje të videoeve, rregullon çështje të tjera në kompetencë të Agjencisë, si çështje administrative, dhe çështje në fushën e marrëdhënieve të punës.

Në përfundim konstaton qëndrimet e marra për çështje që Këshilli i Agjencisë i shqyrton në seancë, konstaton mendime mbi propozimet e akteve nënligjore dhe rregullave të tjera në kompetencë të Agjencisë, miraton vendim për çështje të caktuara në lidhje me organizimin e brendshëm të Agjencisë, kryen ndarjen e detyrave nëpër sektor dhe njësitë e tjera të Agjencisë, miraton propozimin e drejtorit për iniciimin e procedurës për marrjen e lejes për transmetim televiziv ose radio, miraton propozimet e drejtorit/ dhe të zëvendësit të drejtorit për marrjen e vendimeve në kompetencë të Këshillit dhe merren qëndrime për çështje të tjera në kompetencë të Agjencisë.

Plan programi përcakton çështje të ndryshme në kompetencë të Agjencisë për të cilat nevojitet përcaktimi i dinamikës dhe afateve. Programi gjithashtu përmban dhe plan financiar për punën e Agjencisë.

Me vendim urdhërohet dhe ndalon veprimin në situatë të caktuar të cilat kanë rëndësi të përgjithshme për zbatimin e ligjeve dhe dispozitave të tjera, urdhërohet dhe ndalohet nxjerrja ose dhënia e dokumenteve nga arkivi i Agjencisë në situata të caktuara nëse është e nevojshme, dhe të ngjajshme.

Me metodologjinë detajisht përshkruhet mënyra, hapat, teknikat dhe principet që do të përdoren për kryerjen e mbikëqyrjeve programore, si dhe për kryerjen e hulumtimeve, projekteve, analizave ose aktiviteteve të tjera. Metodologjia përdoret për të siguruar kornizë të qartë dhe të qëndrueshme të punës.

Me politikën definoen drejtimit, principet dhe rregullat që do të shërbejnë si udhërrëfyes për miratimin e vendimeve dhe për harmonizimin e aktiviteteve të Agjencisë për qëllimet e vëna.

III. LLOGARIDHËNIA PËR PUNËN E AGJENCISË

Neni 11

Agjencia për punën e saj jep llogari para Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut duke paraqitur raport mbi punën e saj.

Raporti nga paragrafi (1) të këtij neni, Agjencia e publikon në ueb-faqen e saj dhe të njëjtën e paraqet në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut për shqyrtim jo më vonë se 31 Mars të vitit aktual.

Raporti mbi punën e Agjencisë përmban:

- a) raport vjetor mbi punën e Agjencisë për vitin paraprak dhe
- b) programin vjetor të punës së Agjencisë për vitin e ardhshëm.

Raportin vjetor të punës së Agjencisë për vitin paraprak, nga paragrafi (3) pika a) të këtij neni përmban veçanërisht:

- raport mbi zbatimin e aktiviteteve të përcaktuara në programin vjetor të punës së Agjencisë për vitin e kaluar, në të cilin duhet të tregohet realizimi i planit vjetor të mbikëqyrjes së programeve,
- raport financiar për realizimin e planit financiar në vitin paraprak dhe llogari vjetore me të dhëna për realizimin e të ardhurave, shpenzimeve, kërkesave, dhe detyrimeve për vitin e kaluar të grupuara sipas strukturës dhe strukturës organizative të Agjencisë dhe
- raport revizioni nga revizor i pavarur ndërkombëtar i çertifikuar nga Enti Shtetëror për revizion, nëse është kryer revizion, si dhe qëndrimi i Agjencisë në lidhje me rezultatet nga revizioni i kryer.

Me programin vjetor të punës së Agjencisë për vitin e ardhshëm nga paragrafi (3) pika b) të këtij neni përcaktohen detyrat dhe qëllimet që Agjencia duhet të përmbushë në vitin e ardhshëm, në përputhje me LSHMAAV dhe LM dhe në veçanti përmban:

- programi i aktiviteteve të planifikuara dhe
- planin financiar për vitin e ardhshëm, i cili përmban të dhëna për realizimin e aktiviteteve të planifikuara, të ardhurat dhe shpenzimet e planifikuara të Agjencisë për vitin e ardhshëm të grupuara sipas strukturës dhe sipas organizimit strukturor të Agjencisë, si dhe investimet kapitale të parashikuara të Agjencisë për vitin e ardhshëm.

IV ORGANET E AGJENCISË

Neni 12

Organet e Agjencisë janë: Këshilli dhe Drejtori.

Këshilli përbëhet nga shtatë anëtarë.

Neni 13

Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut i emëron anëtarët e Këshillit në bazë të konkursit publik të zbatuar paraprakisht dhe organizimit të debatit publik për kandidatët për anëtarë të Këshillit.

Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut shpall konkurs publik, në të cilin mund të paraqiten kandidatë për anëtarë të Këshillit, jo më vonë se gjashtë muaj para skadimit të mandatit të anëtarit të Këshillit.

Gjatë përcaktimit të propozimit të kandidatëve për anëtarë të Këshillit, Komisioni për zgjidhjen e çështjes dhe emërimeve në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë, do të marrë parasysh përfaqësimin përkatës dhe të drejtë, gjinor dhe etnik të qytetarëve të Republikës së Maqedonisë.

Kryetari i Këshillit është i detyruar ta njoftojë Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut për skadimin e mandatit të anëtarëve të Këshillit jo më vonë se gjashtë muaj para skadimit të afatit.

Kryetari ose anëtarët e Këshillit që i kryejnë këto funksione mund të shkarkohen nëse më tej nuk i përmbushin kushtet e kërkuara për kryerjen e funksionit. Procedura e shkarkimit është publike.

Neni 14

Anëtarët e Këshillit profesionalisht të angazhuar në Agjencion me orar të plotë pune.

Anëtarët e Këshillit emërohen për periudhë pesë vjeçare.

Anëtarët e Këshillit kanë të drejtë edhe për një mandat të njëpasnjëshëm ose jo të njëpasnjëshëm, në bazë të procedurës së njëjtë të përcaktuar në nenin 14 të LSHMAAV.

V.Kompetencat e Këshillit të Agjencisë

Neni 15

Këshilli ka këto kompetenca:

- miraton vendim për shpalljen e konkursit publik për dhënien e lejes për transmetim televiziv dhe radio,
- miraton vendim për dhënien, heqjen ose vazhdimin e lejes për transmetim televiziv ose radio,
- miraton vendim që lejon, përkatësisht ndalon ndryshim në strukturën e pronësisë së transmetuesit,
- miraton vendim me të cilën anulohet vendimi që lejon ndryshim në strukturën e pronësisë së transmetuesit,
- miraton vendim për iniciimin e procedurës për caktimin e ekzistimit të koncentrit të palejuar mediatik, sipas detyrës zyrtare,
- miraton vendim që përcakton ekzistencën e koncentrit të palejuar mediatik,
- vendos për çështje lidhur me identifikimin dhe regjistrimin e shërbimeve të platformës për ndarjen e videove dhe kërkesat që duhen përmbushur, si publikim impresium, detyrimet e tyre, masat për sigurimin e respektimit të detyrimeve dhe çështjeve lidhur me zgjidhjen e mosmarrëveshjeve,
- miraton akte nënligjore që burojnë nga LSHMAAV dhe LM,
- miraton akte të përgjithshme për punën e Agjencisë,
- miraton Rregulloren për punë në Agjenci,
- miraton llogarinë përfundimtare të Agjencisë,
- miraton raportin vjetor të punës për vitin paraprak dhe programin vjetor të punës për vitin e ardhshëm të Agjencisë të cilat janë pjesë përbërëse e raportit të punës të Agjencisë nga neni 8 të LSHMAAV,
- miraton planin vjetor për kryerjen e mbikëqyrjes programore dhe Metodologjinë për kryerjen e mbikëqyrjes programore,
- vendos për ndërmarrjen e masës për kufizim të përkohshëm të transmetimit dhe pranimin e shërbimeve mediatike audio ose audiovizuale nga vendet e tjera në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut,
- miraton vendim për përcaktimin e listës së eventeve (ngjarjeve) të rëndësishme për publikun e Republikës së Maqedonisë së Veriut,
- miraton Kodin e Sjelljes për anëtarët e Këshillit dhe të punësuarit në shërbimin profesional të Agjencisë,
- zgjedh dhe shkarkon drejtorin dhe zëvendësin e drejtorit të Agjencisë në përputhje me LSHMAAV dhe sipas procedurës së përcaktuar në Rregulloren e Punës të Agjencisë,

- jep miratim për marrjen e vendimeve të drejtorit të Agjencisë për posedimin e pasurisë, si dhe për punësim dhe pushimin nga puna të punonjësve në shërbimin profesional të Agjencisë,
- monitoron zbatimin e programit vjetor të punës së Agjencisë përmes raporteve tremujore të paraqitura nga drejtori i Agjencisë,
- miraton vendime për ndërmarrjen e masave në përputhje me ligjin në rastet e kryerjes së shkeljes së dispozitave të LSHMAAV dhe LM ose të dispozitave të miratuara në bazë të ligjit të njëjtë dhe kushteve dhe detyrimeve nga lejet,
- miraton vendime për ndërmarrjen e masave për kufizim të përkohshëm të transmetimit dhe pranimit të shërbimeve mediatike audio ose audiovizuale nga vende të tjera në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut,
- shqyrton dhe merr qëndrim me parashtresë nga të punësuarit në Agjenci në lidhje me vendimet e drejtorit/dhe zëvendësit të drejtorit që vendosin për të drejtat e punonjësve dhe
- kryen punë të tjera të përcaktuara në LSHMAAV dhe LM.

Neni 16

Këshilli miraton Planin për furnizime publike të Agjencisë, dhe për ndryshime dhe plotësime, miraton planin financiar për vitin e ardhshëm (që përmban të dhëna për realizimin e aktiviteteve të planifikuara, të ardhurat dhe shpenzimet e planifikuara të Agjencisë për vitin e ardhshëm të grupuara sipas strukturës dhe sipas strukturës organizative të Agjencisë, si dhe investimet kapitale të parashikuara të Agjencisë për vitin e ardhshëm), përkatësisht ribalancin e Planit financiar vjetor, jep pëlqim për miratimin e vendimeve nga Drejtori i Agjencisë për zbatimin e procedurave për furnizime publike, për bashkëfinancim të projekteve nga Instrumenti për paraanëtarësim në Bashkimin Evropian (IPA) dhe të ngjajshme.

Për kostot financiare në lidhje me funksionimin aktual të Agjencisë si shpenzime të përgjithëshme të regjisë, parapagesat për shtypin ditor/publikim elektronik dhe të ngjajshme, vendos drejtori i Agjencisë, pa miratimin paraprak nga Këshilli. Për shpenzimet financiare lidhur me udhëtimet zyrtare, mjetet për reprezentim, anëtarësimet në organizata ndërkombëtare, trajnime me pagesë të punonjësve vendos Drejtori i Agjencisë dhe për këtë e njofton kryetarin e Këshillit të Agjencisë.

VI. Mënyra dhe procedura për zhvillimin e seancave të këshillit të Agjencisë, Takimet publike

VI.1 Seancat e Kuvendit

Neni 17

Për punën dhe kompetencat e përcaktuar në SHMAAV, Këshilli punon dhe vendos në seanca.

Këshilli është i detyruar të mbajë së paku një seancë në muaj.

Këshilli punon me kворum prej së paku pesë anëtarësh, dhe vendimet, aktet e tjera i miraton me shumicë votash të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Këshillit.

Këshilli për kompetencat nga neni 18 nënparagrafi 15 të LSHMAAV vendos me shumicë votash nga numri i përgjithshëm të anëtarëve të Këshillit në të cilën duhet të ketë shumicë votash nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Këshillit që i përkasin bashkësisë që nuk është shumicë në Republikën e Maqedonisë.

Vendimet dhe aktet e tjera të Këshillit nënshkruhen nga kryetari i Këshillit, ose në rast të mungesës së tij, zëvendësi i kryetarit të Këshillit, më së voni në afat prej tre ditësh nga dita e miratimit.

Në rast të mungesës ose pengesës së kryetarit të Këshillit ose të zëvendësit të kryetarit të Këshillit, anëtarët e Këshillit autorizojnë një nga anëtarët e Këshillit për të nënshkruar vendimet dhe aktet nga paragrafi (4) i këtij neni.

Neni 18

Nëse anëtar i Këshillit konsideron se ka interes privat direkt ose indirekt në lidhje me miratimin e vendimeve brenda kompetencës së Këshillit, anëtar i Këshillit është i obliguar të informojë Këshillin.

Në rastin e paragrafit (1) të këtij neni, Këshilli vepron në përputhje me Ligjin për parandalim konflikt të interesit.

Neni 19

Seancat e Këshillit mbahen me prezencë fizike të anëtarëve të Këshillit të Agjencisë.

Sipas opcionit, seancat mund të mbahen duke përdorur mjete komunikimi elektronik që ofrojnë komunikim të njëkohshëm dypalësh nëpërmjet platformës video-konferencë ose seance të kombinuar (disa anëtarë me prezencë fizike dhe disa nëpërmjet platformës).

Neni 20

Seancat e Këshillit të Agjencisë, me prezencë fizike mbahen, rregullisht në ambientet e Agjencisë.

Seancat e Këshillit të Agjencisë, nëse nuk ka mundësi që të mbahen me prezencë fizike, mbahen nëpërmjet platformës së komunikimit dypalësh nëpërmjet platformës video-konferencë. Kur seancat e Këshillit të Agjencisë mbahen nëpërmjet platformës video-konferencë, dërgohet ftesë për seancë dhe linku për bashkangjitje në seancë.

Senca e kombinur është seancë ku disa nga anëtarët janë të pranishëm me prezencë fizike, dhe disa nga anëtarët marrin pjesë në mbajtjen e seancës nëpërmjet platformës për komunikim të njëkohshëm dypalësh.

Neni 21

Seancat e Këshillit i thërret kryetari i Këshillit me iniciativën e tij, ndërsa në rast të mungesës ose pamundësisë së tij për të marrë pjesë, me iniciativë të zëvendësit të kryetarit të Këshillit, përkatësisht anëtarit të autorizuar të Këshillit.

Kryetari i Këshillit obligohet të thërret seancë të Këshillit me propozim me shkrim nga tre anëtarë të Këshillit, ose me propozim me shkrim të drejtorit të Agjencisë, më së voni në afat prej tri ditësh nga dita e pranimi të propozimit.

Kryetari i Këshillit thërret duke dërguar ftesë për seancë anëtarëve të Këshillit me anë të postës elektronike (e-mail)

Ftesa nga paragrafi (3) të këtij neni duhet të përmbajë vendin dhe kohën e mbajtjes së seancës, me bashkëngjitje të propozim rendit të ditës.

Ftesa duhet të dërgohet jo më vonë se një ditë para ditës së mbajtjes së seancës, dhe në raste të jashtëzakonshme, edhe më shkurt në varësi të urgjencës së vendimmarrjes për çështje të caktuar.

Me përjashtim, kur e kërkojnë rrethana të veçanta, kryetari mund të thërrasë seancën e këshillit me telefon.

Anëtarët e Këshillit që nuk do të jenë në gjendje të marrin pjesë në seancën e planifikuar, për mungesën e tyre duhet të njoftojnë kryetarin e Këshillit, nëpërmjet e-mailit ose me telefon.

Neni 22

Kryetari i Këshillit kryeson me seancën e Këshillit dhe e përfaqëson Këshillin

Në rast të mungesës ose pamundësisë së kryetarit të Këshillit, detyrat nga paragrafi (1) të këtij neni i kryen zëvendësi i kryetarit të Këshillit

Neni 23

Në seancën e Këshillit gjithashtu merr pjesë dhe drejtori i Agjencisë, pa të drejtë vote, dhe mund të marrin pjesë dhe persona të tjerë të punësuar në shërbimin profesional të Agjencisë, si dhe persona të tjerë të jashtëm.

Prezenca e mediave në seanca të Këshillit nuk lejohet në rastet kur publikohen informacione me shenjë “për përdorim të kufizuar”.

Gazetarët që profesionalisht e ndjekin punën e Këshillit dhe personat e tjerë (të jashtëm) që janë të interesuar për ndjekjen e seancës, lajmërojnë prezencën e tyre në agjenci para fillimit të saj.

Neni 24

Rendi i ditës për seancën e Këshillit, përcaktohet në fillim të seancës me propozim të kryetarit të Këshillit, dhe në rast të mungesës ose pamundësisë, nga zëvendësi i kryetarit të Këshillit, përkatësisht anëtar i autorizuar i Këshillit.

Çdo anëtar i Këshillit në fillim të seancës, mund të propozoj, pikë shtesë në rendin e ditës.

Pas përcaktimit të rendit të ditës në seancë, Këshilli vazhdon me miratimin e procesverbalit nga seanca e mëparshme, në mënyrë që secili anëtar i Këshillit, drejtori dhe persona të punësuar në shërbimin profesional të Agjencisë që marrin pjesë në seancë, kanë të drejtë të japin sugjerime në procesverbal.

Nëse vërejtjet e dhëna pranohen nga anëtarët e tjerë të Këshillit, ato përfshihen në procesverbal dhe konsiderohet i miratuar së bashku me sugjerimet e dhëna.

Secili anëtar i Këshillit ka të drejtë të kërkojë që në procesverbal të futet dhe mendimi kundërshtues.

Procesverbali që Këshilli do të miraton në seancë do të nënshkruhet nga kryetari i Këshillit dhe personi që mban procesverbalin.

Në rast të mungesës së kryetarit të Këshillit, procesverbali nga paragrafi (4) të këtij neni do të nënshkruhet nga zëvendësi i kryetarit të Këshillit, përkatësisht anëtar i autorizuar nga Këshilli.

Neni 25

Procesverbali i mbajtur në seancën e Këshillit duhet të përmbajné:

- numrin rendor të seancës;
- data, ora dhe vendi ku mbahet seanca;
- evidencë për anëtarët e pranishëm të Këshillit dhe personave të tjerë (të punësuar në shërbim profesional dhe persona të jashtëm) në seancë;
- evidencë për anëtarët në mungesë të Këshillit, dhe arsyen për mosprezencën e tyre;
- deklaram dhe votimi i anëtarëve të Këshillit në pika të veçanta nga rendi i ditës së përcaktuar;
- të gjitha vendimet dhe konkluzionet që janë marrë përkatësisht miratuar sipas pikave në veçanti të rendit të ditës.

Neni 26

Në seancën e Këshillit kryhet regjistrimi audio dhe video.

Pas seancës së Këshillit përgatitet kronikë.

Neni 27

Agjencia në ueb-faqen e saj publikon rendin e ditës të seancës së Këshillit, jo më vonë se një ditë para ditës së mbajtjes së saj.

Procesverbali i miratuar nga seanca e Këshillit me deklaratën dhe votimet e anëtarëve të Këshillit, kronikat e seancave, si dhe vendimet e miratuara dhe të tjerat akte, Agjencia i publikon në ueb-faqen e saj, në afat prej shtatë ditësh nga dita e mbajtjes së seancës.

Neni 28

Materialet e përgatitura për seancat e Këshillit, shërbimi profesional i Agjencisë i dorëzon te kryetari i Këshillit të Agjencisë, zëvendësi i kryetarit të Këshillit dhe anëtarëve të Këshillit të Agjencisë.

Materialet nga paragrafi (1) të këtij neni dorëzohen përmes postës elektronike (e-mail), një ditë para ditës së mbajtjes së seancës së Këshillit.

Në rast të pamundur për dorëzimin e materialeve nga paragrafit (1) të këtij neni në mënyrë elektronike, ato dorëzohen në formë të shtypur (letër).

VI.2 Takime publike

Neni 29

Agjencia kryen detyrat brenda kompetencës së sajë në mënyrë transparente, duke u mundësuar të gjitha palëve të interesuara të kenë informacion për funksionimin e saj.

Neni 30

Agjencia është e detyruar së paku një herë në tre muaj gjatë vitit të organizojë takime publike në mënyrë që tu mundësojë të gjithë palëve të interesuara, të shprehin qëndrimet dhe mendimet e tyre në lidhje me zhvillimin e shërbimeve mediatike audio dhe audiovizuale në Republikën e Maqedonisë së Veriut, në veçanti për gjendjen e tregut për shërbimet mediatike audio dhe audiovizuale në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe realizimi i aktiviteteve dhe përmbushjen e objektivave të programit vjetor të punës së Agjencisë.

Pikëpamjet dhe mendimet e marra nga paragrafi (1) të këtij neni, si dhe qëndrimi i Agjencisë në lidhje me të njëjtën në afat prej shtatë ditësh nga dita e mbajtjes së takimit publik, publikohen në ueb-faqe të Agjencisë.

VII. EMËRIMI DHE SHKARKIMI I KRYETARIT DHE ZËVENDËSIT TË KRYETARIT TË KËSHILLIT TË AGJENCISË

Neni 31

Seanca konstitutive në të cilën zgjidhet kryetari dhe zëvendësi i kryetarit të Këshillit caktohet nga Kryetari, përkatësisht nga zëvendësi i kryetarit të Këshillit nga përbërja e mëparshme.

Kryetari, përkatësisht zëvendësi i kryetarit të Këshillit nga përbërja e mëparshme cakton seancë konstituive deri në zgjedhjen e kryetarit të Këshillit të Agjencisë

Nëse kryetari, kryesisht zëvendësi i kryetarit të Këshillit nga përbërja e mëparshme nuk cakton seancë konstituive në afat prej 15 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të Vendimit për emërimin e anëtarëve të Këshillit të Agjencisë ky vendim mirret me propozimin e së paku 5 anëtarëve të emëruar.

Në rastin e paragrafit (3) të këtij neni, seancën konstitutive e drejton anëtari i sapo zgjedhur nga Këshilli me shumicë votash.

Neni 32

Këshilli nga rradhët e anëtarëve të tij zgjedh dhe shkarkon kryetarin dhe zëvendësin e kryetarit.

Çdo anëtar i Këshillit mund të propozojë kandidat për kryetar të Këshillit.

Propozimi për kandidat për kryetar të Këshillit parashtrohet në seancën e Këshillit, me gojë ose shkrim.

Propozimi për kandidat për kryetar të Këshillit përmban emrin dhe mbiemrin e kandidatit, arsyen e propozimit, si dhe emrin dhe mbiemrin e anëtarit të Këshillit që e paraqet propozimin.

Renditja e kandidatëve për kryetar të Këshillit përcaktohet sipas rendit alfabetik të shkronjës së parë të mbiemrit.

Neni 33

Kryetari i këshillit zgjidhet me votim publik.

Zgjedhja e kryetarit të Këshillit mund të kryhet dhe me votim të fshehtë, nëse ashtu vendos Këshilli. Propozim për votim të fshehtë mund të japë çdo anëtar i Këshillit. Nëse zgjedhja kryhet me votim të fshehtë, procesin e ndjek komision i përbërë nga tre anëtarë (kryetari i seancës konstituive dhe dy anëtarë të Këshillit).

Neni 34

Votimi për kandidatin për kryetar kryhet sipas rendit të përcaktuar.

Secili anëtar i Këshillit voton vetëm për njërin nga kandidatët e propozuar (nominuar).

Neni 35

Për kryetar të Këshillit zgjidhet kandidati që mori shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Këshillit.

Nëse në votimin e parë askush nga kandidatët nuk ka marrë shumicën e votave të nevojshme, procedura për zgjedhjen e kryetarit të Këshillit përsëritet deri në zgjedhjen e kryetarit.

Nëse për kryetar janë propozuar tre ose më shumë kandidatë, votimi do të përsëritet për dy kandidatët që kanë marrë numrin më të lartë të votave në votimin e parë.

Nëse në mesin e kandidatëve me numër më të lartë të votave ka kandidatë me të njëjtin numër votash, votimi përsëritet për të gjithë kandidatët me numër më të madh votash.

Nëse edhe në votimin e përsëritur asnjë nga kandidatët nuk ka marrë shumicën e votave, procedura për zgjedhjen e kryetarit të Këshillit përsëritet.

Neni 36

Pas zgjedhjes së kryetarit të Këshillit, kryetari vazhdon të kryesoj seancën konstituive, pas së cilës inicohet për zgjedhjen e zëvendësit të kryetarit të Këshillit.

Dispozitat e kësaj Rregulloreje në lidhje me zgjedhjen e kryetarit të Këshillit gjithashtu aplikohet dhe për zgjedhjen e zëvendësit të kryetarit të Këshillit.

Neni 37

Kryetari i Këshillit mund të shkarkohet në seancë të Këshillit, në rastet e mëposhtme;

- me kërkesë të tij
 - duke pranuar funksione ose punë që nuk janë brenda funksionit si antar i Këshillit në përputhje me Ligjin
 - nëse është dënuar me vendim të formës së prerë për veprë penale me të cilën parashihet dënim me burg në kohëzgjatje prej gjashtë muajsh ose është shqiptuar masa e sigurisë ndalesë për ushtrim të profesionit, veprimtarisë ose detyrë në kohëzgjatje më shumë se gjashtë muaj,
 - nëse nuk është në gjendje të kryejë detyrat më shumë se gjashtë muaj në kontinuitet,
 - ka ndonjë nga pengesat për anëtarësim në Këshill të prashikuar në nenin 16 të LSHMAAV,
 - mungon pa arsye në tre seanca radhazi të Këshillit ose nga pesë seanca gjatë një viti në përputhje me Rregulloren e Punës së Agjencisë
 - nëse konstatohet se anëtari i Këshillit në procedurën për emërimin e tij ka paraqitur të dhëna të pasakta ose nuk ka dhënë ndonjë informacion që do të ndikonte në emërimin e tij,
 - nëse e kryen me neglizhencë funksionin e kryetarit të Këshillit, përkatësisht nëse nuk vepron në përputhje me dispozitat e Rregullores së Punës së Agjencisë.
- Propozim për shkarkimin e kryetarit të Këshillit jep çdo anëtar i këshillit.

Kryetari i Këshillit shkarkohet me vendim të marrë me shumicë të votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Këshillit.

Dispozitat e paragrafëve 1, 2 dhe 3 të këtij neni zbatohen dhe për shkarkimin e zëvendësit të kryetarit të Këshillit.

VIII. EMËRIMI DHE SHKARKIMI I DREJTORIT TË AGJENCISË DHE ZËVENDËSIT TË DREJTORIT

Neni 38

Këshilli zgjedh drejtorin e Agjencisë dhe zëvendësin e drejtorit të Agjencisë (në tekstin mëposhtë: drejtori) përmes një konkursi publik.

Për tu zgjedhur drejtori i Agjencisë / zëvendës i drejtorit të Agjencisë, kandidati duhet të ketë arsim të lartë dhe përvojë pune së paku prej 8 (tetë) vitesh në fushën e komunikimit, gazetari, informatikë, kulturë, ekonomi ose drejtësi, si dhe përvojë në udhëheqjen e organizatave së paku prej katër vitesh.

Kandidati për drejtor i Agjencisë / zëvendës i drejtorit të Agjencisë nuk duhet të ketë qenë anëtar i organeve dhe trupave (strukturave) dhe nëse nuk është zgjedhur ose emëruar person, zyrtar që drejton një organ të administratës publike, ministri dhe organ drejtues në ndërmarrje publike dhe shoqëri aksionare, të themeluara nga shteti për një periudhë prej 10 vitesh, të llogaritur nga viti në të cilën e paraqet kandidaturën.

Këshilli është i detyruar të zgjedhë drejtorin e Agjencisë / zëvendësin e drejtorit të Agjencisë jo më vonë se 30 ditë para skadimit të mandatit të paraardhësit të tij.

Neni 39

Drejtori i Agjencisë / zëvendësi i drejtorit të Agjencisë, bashkëshorti ose partneri i tij jashtëmartesor, si dhe të afërmit e ngushtë të brezit të parë deri në brezin e dytë, nuk mund të kenë pjesë të aksioneve, drejtëpërdrejtë ose indirekt në organizatat që kryejnë aktivitete që janë nën kompetencat e Agjencisë.

Neni 40

Drejtori i Agjencisë dhe zëvendësi i drejtorit të Agjencisë janë profesionalisht të angazhuar në Agjenci me orar të plotë pune.

Mandati i drejtorit të Agjencisë / zëvendës i drejtorit të Agjencisë, është pesë vjet, me të drejtë për një mandat tjetër.

Nëse mandati i drejtorit ka përfunduar, dhe procedura për zgjedhjen e drejtorit nuk është përfunduar, drejtori vazhdon të ushtrijë detyrën deri në zgjedhjen e drejtorit, por jo më gjatë se gjashtë muaj.

Neni 41

Drejtori organizon dhe udhëheq me punën e Agjencisë, është përgjegjës për funksionimin ligjor të Agjencisë dhe ka kompetencat në vijim:

- përfaqëson dhe prezanton Agjencinë,
- nënshkruan kontrata në emër të Agjencisë,
- propozon aktet e përgjithshme të punës së Agjencisë,
- propozon Rregulloren e Punës së Agjencisë raportin vjetor të punës dhe planin vjetor të punës së Agjencisë të cilat janë pjesë përbërëse e raportit të punës së Agjencisë nga neni 8 të LSHMAAV,
- propozon planin vjetor për kryerjen e mbikëqyrjes së programit dhe Metodologjin për kryerjen e mbikëqyrjes së programeve,
- miraton aktvendime për çështje në kompetencë të Agjencisë,
- jep çertifikata për regjistrim të përcaktuara me LSHMAAV,

- propozon vendime në kompetencë të Këshillit,
- propozon aktet nënligjore që janë në kompetencë të Këshillit,
- propozon lista të eventeve më të rëndësishme për publikun e Republikës së Maqedonisë së Veriut,
- autorizon persona të tjerë në kuadër të kompetencave të tij ligjore,
- vendos për punësime dhe pozicionim të të punësuarve në shërbimin profesional të Agjencisë,
- kryen dhe punë të tjera të përcaktuara në LSHMAAV, LM dhe Rregulloren.

Drejtori është i detyruar që Këshillit t'i paraqesë raporte tremujore për zbatimin e programit vjetor të punës së Agjencisë, si dhe raporte tremujore për masat e shqiptuara në përputhje me LSHMAAV në rastet e shkeljes së kryera të dispozitave të LSHMAAV, LM ose të dispozitave të miratuara në bazë të ligjit dhe kushteve dhe detyrimeve të lejes dhe raport mbi aktivitetin ndërkombëtar të Agjencisë dhe aktivitetet e planifikuara në periudhën e ardhshme.

Drejtori ka të drejtë të autorizojë persona të tjerë të punësuar në Agjenci, në kuadër të kompetencave dhe përgjegjësi të tij për menazhim në rast kur ai s'është prezent, po ashtu dhe zëvendësi i kryetarit të Agjencisë ose për arsye të tjera nuk është në gjendje të kryejë funksionin e tij, me të gjitha kompetencat të përcaktuara në nenin 29 paragrafi 1 dhe 2 të LSHMAAV.

Neni 42

Zëvendësi i drejtorit të Agjencisë e zëvendëson drejtorin e Agjencisë në rastë nëse nuk është prezent ose për shkaqe shëndetësore ose arsye të tjera nuk është në gjendje të kryejë funksionin e tij, në të gjitha kompetencat dhe përgjegjësitë udhëheqëse.

Në bashkëpunim me drejtorin e Agjencisë, zëvendësi i drejtorit kryen detyra në kompetencë të drejtorit të Agjencisë, të cilat ai ia beson.

Neni 43

Në rast nevojë për punësim në shërbimin profesional të Agjencisë, drejtori paraqet propozim në Këshill për miratimin e vendimit për hapjen e konkursit për marrëdhënie pune dhe për zbatimin e procedurës për punësim në shërbimin profesional dhe për anëtarë të Komisionit për evaluim të aplikimeve të dorëzuara të kandidatëve sipas konkursi të publikuar për punësim në shërbimin profesional të Agjencisë/zëvendësit përkatës.

Pas marrjes së miratimit drejtori merr vendim për shpalljen e njoftimit për marrëdhënie pune dhe marrjen e vendimit për zgjedhjen e kandidatit për atë vend pune.

Drejtori i Agjencisë vendos për pozicionimin e punonjësve në Shërbim profesional të Agjencisë.

Drejtori i Agjencisë dy herë në vit, pas evaluimit të punës së të punësuarve në Shërbimin profesional të Agjencisë, informon Këshillin e Agjencisë për pozicionimet e kryera të të punësuarve në Shërbimin profesional të Agjencisë nga një vend pune në tjetër.

Në rast nëse i punësuar në shërbimin profesional të Agjencisë paraqet kërkesë për anulimin e kontratës së punës, drejtori për këtë do të informojë Këshillin, i cili vetëm e konfirmon anulimin e kontratës.

Këshilli miraton propozimin e Drejtorit për shkarkim të të punësuarve në shërbimin profesional të Agjencisë. Vendimi për ndërprerjen e marrëdhënies së punës mbi këtë bazë e miraton Këshilli.

Neni 44

Drejtori i Agjencisë/zëvendësi i drejtorit të Agjencisë mund të shkarkohet nga Këshilli vetëm në rastet e mëposhtme:

- a) me kërkesë të tij;
- b) në rast të pengesës për kryerjen e funksionit për shkaqe shëndetësore më shumë se gjashtë muaj;
- v) pranim i funksioni ose pune që janë të pakrahasueshme me funksionin e drejtorit;

g) nëse është dënua për vepër penale ku është shqiptua dënim me burg në kohëzgjatje prej gjashtë muajsh ose është shqiptua masë sigurie për ndalesë të kryerjes së profesionit, veprimtari ose detyrë, në kohëzgjatje më shumë se gjashtë muaj;

d) shkelje e dispozitave të LSHMAAV ose rregullave të miratuara në bazë të Ligjit që mund të konstatohet nga raporti i punës së Agjencisë ose

gj) abuzim me funksionin sipas raportit të revizionit nga neni 8 të LSHMAAV.

Neni 45

Vendimi për shkarkimin e drejtorit / zëvendësit të drejtorit, mes tjerave duhet të përmbajë arsyet për shkarkimin e tij, shpjegim të detajuar dhe duhet të publikuar në ueb-faqen e Agjencisë në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e miratimit të vendimit.

Nëse drejtori është shkarkuar, ndërsa procedura për zgjedhjen e drejtorit nuk ka përfunduar, funksionin e drejtorit do ta kryejë zëvendësi i drejtorit të Agjencisë, për periudhë prej jo më shumë se tre muaj.

Neni 46

Vendimi për shkarkimin e drejtorit/zëvendësit të drejtorit është përfundimtar, dhe kundër tij mund të ngrihet padi në gjykatën përkatëse, në përputhshmëri me Ligjin.

Drejtorit/zëvendësit të drejtorit kundër të cilit janë duke u zhvilluar procedura për shkarkim u mundësohet mbrojtja para Këshillit.

IX.PROCEDURA PËR MIRATIMIN E AKTEVE NËNLIGJORE DHE AKTEVE TË TJERA QË BUROJNË NGA LIGJI PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE

Neni 47

Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele miraton akte nënligjore dhe akte të tjera që burojnë në përputhje me Ligjin për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele dhe Ligjin për Media me propozim të drejtorit.

Procedura për miratimin e akteve nënligjore dhe akteve të tjera nga paragrafin (1) të këtij neni, mund të përbëhet nga dy faza: draft dhe propozim.

Neni 48

Aktet nënligjore dhe aktet e tjera në kompetencë të Agjencisë, propozohen nga drejtori i Agjencisë dhe dorëzohen për shqyrtim dhe miratim në seancën e Këshillit të Agjencisë.

Këshilli në seancë, pas shqyrtimit paraprak dhe dhënies së mendimit dhe vërejtjeve me shumicë votash të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Këshillit, miraton aktet nënligjore dhe aktet e tjera në kompetencë të Agjencisë dhe të njëjtat i publikon në ueb-faqe në përputhje me nenin 27 paragrafi 2 të Rregullores.

Neni 49

Agjencia para se të miratojë ose ndryshojë akt nënligjor në kompetencë të saj, si dhe para se të miraton programin vjetor të punës për vitin e ardhshëm, në ueb-faqe do të publikon aktin nënligjor të propozuar përkatësisht programin vjetor të punës të propozuar për vitin e ardhshëm në mënyrë që të sigurojë debat publik përkatësisht t'u mundësojë të gjitha palëve të interesuara të shprehin mendimet, pikëpamjet dhe sugjerimet e tyre në lidhje me aktet nënligjore të propozuara ose programin vjetor të propozuar të punës për vitin e ardhshëm.

Kohëzgjatja e debatit publik në lidhje me miratimin ose ndryshimin e aktit nënligjor në kompetencë të Agjencisë, si dhe për miratimin e programit vjetor të punës së Agjencisë për vitin e ardhshëm nuk duhet të jetë më i shkurtër se 30 ditë nga dita e publikimit të akteve në ueb-faqen e Agjencisë.

Pas skadimit të afatit nga paragrafi 2 të këtij neni dhe para miratimit të aktit nënligjor, Agjencioni ka detyrim t'i publikon në ueb-faqe mendimet dhe komentet e marra, si dhe qëndrimin e Agjencisë në lidhje me këto.

Neni 50

Në mënyrë që të sigurojë debat publik dhe t'u mundësojë të gjithë palëve të interesuara të shprehin mendimet, pikëpamjet dhe qëndrimet e tyre, Agjencia mund të vendosë, në ueb-faqe të publikojë ndryshimet e propozuara dhe plotësimet e akteve të tjera, për miratimin dhe ndryshimin e të cilave është kompetente Agjencia.

Afati i kohëzgjatjen së debatit publik nga paragrafin 1 të këtij neni Agjencia e përcakton në varësi të llojit dhe karakterit të aktit, përkatësisht kompleksitetit të çështjes së rregulluar me akt.

Neni 51

Pas skadimit të afatit për debat publik dhe marrjes së mendimeve, pikëpamjeve dhe qëndrimeve, përgatitet Propozim - teksti i aktit nënligjorë përkatësisht aktet e tjera për miratimin e të cilëve është kompetente Agjencia, ku drejtori i Agjencisë e dorëzon në Këshillin e Agjencisë për miratim.

Nga momenti i përfundimit të debatit publik deri në mbajtjen e seancës nuk duhet të kalojë më pak se 3 ditë.

Këshilli në seancë miraton aktin nënligjor të propozuar, përkatësisht akt tjetër nën kompetencën e Agjencisë dhe e publikon në ueb-faqen e saj në përputhje me nenin 27 paragrafi 2 të Rregullores.

X.MËNYRA DHE PROCEDURA PËR DHËNIEN, NDËRPRERJEN E VLEFSHMËRISË, HEQJEN DHE VAZHDIMIN E LEJES PËR TRANSMETIM TELEVIZIV OSE RADIO

X.1Dhënia e lejes për transmetim televiziv ose radio

Neni 52

Leja për transmetim televiziv ose radio jepet nga Agjencia për nivel të caktuar të shikueshmërisë ose dëgjueshmërisë në nivel (shtetëror, rajonal ose lokal) dhe zotëruesi i lejes fiton të drejtën për transmetim të shërbimit programor televiziv ose radio në zonën për të cilën i është dhënë leja.

Leja për transmetim televiziv ose radio të shoqërive tregtare radiodifuzive dhe të institucioneve jofitimprurëse radiodifuzive ndahet në afat kohor prej nëntë vjetësh me mundësinë për vazhdimin e saj.

Për lejen e transmetimit televiziv ose radio transmetuesit me përjashtim të shërbimit publik radiodifuziv, paguajn kompensim vjetor në llogarinë e Agjencisë në përputhje me LSHMAAV.

Neni 53

Për shërbimin programor të radios tokësore që transmetohet nëpërmjet resursi të kufizuar siç janë radiofrekuencat ose kapaciteti transmetues të multipleksit digjital tokësor, leja për transmetim në radio ndahet nga Agjencia përmes konkursi publik.

Për shërbimin programor të televizionit tokësor nëse transmetohet nëpërmjet resursi të kufizuar mund të transmetohet vetëm përmes kapacitetit transmetues të multipleksi digjital tokësor për të cilin leja për transmetim televiziv ndahet nga Agjencia nëpërmjet konkursi publik.

Për shërbimin programor në radio ose televizion që transmetohet përmes rrjetit publik të komunikimit elektronik që nuk përdor resurs të kufizuar ose përmes sateliti, Agjencia pa konkurs publik jep leje për transmetim televiziv ose radio.

Neni 54

Procedura për dhënien e lejes për transmetim televiziv ose radio është transparente dhe kryhet në mënyrë që siguron tretman të drejtëpërdrejt, të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë pjesëmarrësit në procedurë.

Mënyra dhe procedura për dhënien e lejes për transmetim televiziv dhe radio janë të përshkruara në kapitullin V.3.2. të LSHMAAV.

X.2 Përfundimi i vlefshmërisë së lejes sipas ligjit.

Neni 55

Leja për transmetim televiziv ose radio ndalon të jetë e vlefshme bazuar në Ligj në rastet e mëposhtme:

- pas skadimit të afatit për të cilën është dhënë,
- me deklaratë me shkrim nga zotëruesi që njofton Agjencinë se ndalon së transmetuari programin televiziv ose radio,
- nëse zotëruesi i lejes pushon së ekzistuari,
- me heqjen e lejes nga Agjencia,
- nëse zotëruesi i lejes falimenton,
- ose nëse likuidohet zotëruesi i lejes.

Për ndalimin e vlefshmërisë së lejes për transmetim televiziv ose radio sipas ligjit, Këshilli nuk merr vendim përveçse në rastet kur leja për transmetim televiziv ose radio pushon me heqjen e lejes nga ana e Këshillit të Agjencisë.

Agjencia do të fshijë transmetuesin nga regjistri i radiodifuzerëve nëse leja ka pushuar së vlefshmi në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni.

X.3. Heqja e lejes për transmetim televiziv ose radio

Neni 56

Agjencia do të heqë lejen për transmetimin televiziv ose radio para skadimit të afatit për të cilën është dhënë dhe do të fshijë transmetuesin nga regjistri i radiodifuzerëve në rastet në vijim, paraprakisht duke paraqitur njoftim me shkrim nëse:

- zotëruesi i lejes nuk fillon me ushtrim të veprimtarisë në afatin e përcaktuar në leje,
- zotëruesi i lejes ka ndërprerë me transmetim të shërbimit programor më shumë se 30 ditë për arsye teknike, financiare ose të tjera,
- zotëruesi i lejes për më shumë se 30 ditë nga dita e fillimit të ushtrimit të veprimtarisë, përcaktuar në leje, nuk i përmbush kushtet teknike, hapësinore, financiare dhe kadrovike që ai ofroi në procedurën për dhënie të lejes, dhe në bazë të mbikëqyrjes së kryer profesionale në përputhje me nenin 30 të LSHMAAV,
- zotëruesi i lejes ka dhënë informacion të pasaktë që ishte i rëndësishëm për miratimin e vendimit për dhënien e lejes,
- pas dhënies së lejes do të ndodhin rrethana që paraqesin pengesa ligjore për ushtrimin e veprimtarisë nga zotëruesi i lejes,
- zotëruesi i lejes nuk paguan kompensimin në afatin e përcaktuar ligjor,
- nuk ka mënjanuar përqëndrimin e paligjshëm mediatik në përputhje me LSHMAAV,
- transmetuesit me vendim të formës së prerë i ndalohet ushtrimi i veprimtarisë.

Neni 57

Këshilli inicon procedurë për heqjen e lejes për transmetim televiziv dhe radio me propozim të drejtorit të Agjencisë.

Propozimi nga paragrafi (1) të këtij neni do të dërgohet të gjithë anëtarëve të Këshillit me shkrim me shpjegim të hollësishëm për arsyet e heqjes së lejes, në përputhje me nenin 82 të LSHMAAV

Këshilli është i detyruar që në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimi të propozimit nga paragrafi (1) të këtij neni të marrë vendim me shumicë votash të anëtarëve të Këshillit.

Nëse Këshilli miraton vendim për heqjen e lejes gjithashtu duhet të japë arsyetim dhe publikohet në “Gazeta Zyrtare të Republikës së Maqedonis së Veriut”, në ueb-faqen e Agjencisë dhe së paku në dy gazeta ditore, prej të cilave njëra është në gjuhën e bashkësisë joshumicë, por që e flasin së paku 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Neni 58

Vendimi për heqjen e lejes për transmetim televiziv ose radio është përfundimtar, dhe kundër këtij vendimi zotëruesi i lejes ka të drejtë të paraqesë padi para gjykatës kompetent në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të vendimit.

Procedura para gjykatës kompetente është urgjente.

X.4.Vazhdimi i lejes për transmetimin televiziv ose radio

Neni 59

Leja për transmetimin televiziv ose radio mund të vazhdohet me kërkesë të zotëruesit për një periudhë prej 9 (nëntë) vjetësh. Kërkes paraqitet në Agjencion në afat prej gjashtë muajsh para skadimit të vlefshmërisë së lejes.

Leja për kryerjen e veprimtarisë radiodifuzive nuk mund t'i transferohet personi tjetër.

Këshilli i Agjencisë detyrimisht miraton vendim në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të kërkesës me të cilën vazhdohet leja, nëse transmetuesi nuk kryen shkelje në përputhje me paragrafin (4) të këtij neni.

Këshilli i Agjencisë miraton vendim për refuzim të kërkesës për vazhdimin e lejes nëse transmetuesi kryen shkelje serioze gjatë kohëzgjatjes së lejes dhe atë:

- së paku tri herë gjatë kohëzgjatjes së lejes kryen mos respektim të ndalesave të veçanta nga neni 48 të LSHMAAV, për të cilin ka vendim të formës së prerë ose
- gjatë kohëzgjatjes së lejes, së paku në një cikël zgjedhor të mbulimi mediatik nuk është kryer në mënyrë të drejtë, të balancuar dhe të paanshme, për të cilat ka vendime gjyqësore të formës së prerë.

Kundër vendimit të Këshillit me të cilën refuzon kërkesën për vazhdimin e lejes, zotëruesi ka të drejtë të ngrejë padi para gjykatës kompetente në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi. Procedura para gjykatës kompetente është urgjente.

XI. MBROJTJA E PLURALIZMIT DHE DIVERSITETIT TË SHËRBIMEVE MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE

XI.1Ndryshimi në strukturën e pronësisë së transmetuesit

Neni 60

Para se të zbatohet ndonjë ndryshim në strukturën e pronësisë, transmetuesi është i detyruar të informojë Agjencinë.

Transmetuesi nuk mund të zbatojë ndryshimin e strukturës së pronësisë para se të miratohet nga Agjencia, përkatësisht pa hyrë në fuqi marrëveshja administrative e referuar në nenin 41 paragrafi 9 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive.

Agjencia është e detyruar që në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimi të njoftimit nga paragrafin 1 të këtij neni, të shqyrtoj nëse me ndryshimet e propozuara në strukturën e pronësisë mund të krijohet koncentrim i palejuar mediatik, në kuptimin e LSHMAAV, përkatësisht nëse ndryshimet e propozuara në strukturën e pronësisë janë në kundërshtim me nenet 34, 35, paragrafi 2 ose 38 të LSHMAAV. Agjencia është e detyruar të bashkëpunojë dhe të shkëmbejë informacion me organe shtetërore dhe trupat në përputhje me LSHMAAV.

Agjencia mund për shkaqe të arsyeshme, të vazhdon afatin nga paragrafi 3 të këtij neni, vetëm njënjëherë, por jo më shumë se 30 (tridhjetë) ditë për të cilën me shkrim do të informojë transmetuesin në afat jo më pak se tre ditë para skadimit të afatit nga paragrafi 3 nga ky ligj.

Neni 61

Nëse në afatet nga neni 60 të kësaj Rregulloreje konstatohet që me propozim ndryshimet në strukturën e pronësisë nuk do të krijohet koncentrim i palejuar mediatik, në kuptimin e LSHMAAV, përkatësisht se i njëjti nuk është në kundërshtim me nenet 34, 35, paragrafi 2 ose 38 të LSHMAAV, Agjencia në afatet nga neni 60 të Rregullores do të marrë vendim ku do të lejojë zbatimin e ndryshimit në strukturën e pronësisë.

Nëse Agjencia nuk merr vendim në afatet nga neni 60 të Rregullores, konsiderohet se zbatimi i ndryshimit në strukturën e pronësisë është miratuar.

Neni 62

Agjencia me vendim do të anulojë vendimin me të cilin lejon zbatimin e ndryshimit në strukturën e pronësisë nëse ai vendim merret në bazë të të dhënave të pasakta ose jo të plota për të cilat është përgjegjës transmetuesi ose janë marrë me mashtrim dhe kishin ndikim vendimtar për miratimin e vendimit.

Vendimi nga paragrafi 1 të këtij neni të Rregullores së Punës, Agjencia e miraton në përputhje me nenin 42 të LSHMAAV.

Agjencia me vendim do ta anulojë vendimin me të cilin lejon zbatimin e ndryshimit në strukturën e pronësisë, nëse transmetuesi nuk e zbaton ndryshimin në strukturën e pronësisë në Regjistrin Qendror në afat prej 90 ditësh nga dita e miratimit të vendimit të Agjencisë.

Nëse transmetuesi nuk vepron në përputhje me vendimin nga paragrafi 1 të këtij neni, Agjencia do të heqë lejen për transmetim televiziv ose radio sipas mënyrës dhe procedurës së përcaktuar me LSHMAAV.

XI.2 Përcaktimi i koncentrimi të paligjshëm mediatik

Neni 63

Ekzistenca e mungesës së përqendrimit të mediave në përputhje me LSHMAAV dhe ekzistenca e shkeljes së ndalesave nga nenet 34,35 paragrafi 2 ose 38 nga ligji i njëjtë përcaktohen nga Agjencia.

Në procedurën për përcaktim të ekzistencës së koncentrimit të paligjshëm mediatik dhe ekzistencës së shkeljes së ndalesës nga nenet 34, 35 paragrafi 2 ose 38 të LSHMAAV, zbatohen dispozitat e Ligjit për procedurë të përgjithshme administrative, nëse me LSHMAAV nuk përcaktohet ndryshe.

Neni 64

Nëse Agjencia në bazë të njohurive të veta ose në bazë të të dhënave të marra nga persona të interesuar është informuar për ekzistencën eventuale të koncentrimi të paligjshëm mediatik, përkatësisht për ekzistimin e shkeljes nga nenet 34, 35 paragrafi 2 ose 38 nga SHMAAV, do ti shqyrtojë këto informacione sipas detyrës zyrtare pa vonesë.

Gjatë kontrollit të informacionit nga paragrafi 1 të këtij neni, Agjencia do të kërkojë nga transmetuesi, brenda një periudhe që nuk mund të jetë më e shkurtër se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë dhe jo më shumë se 45 (dyzet e pesë) ditë, për të dorëzuar të gjitha të dhënat përkatëse për vendimmarrjen e Agjencisë.

Nëse gjatë shqyrtimit të çështjes nga paragrafi 1 të këtij neni Agjencia me vendim do të përcaktojë ekzistencën e koncentrimi të paligjshëm mediatik, përkatësisht shkelja e ndalimit sipas nenit 34, 35 paragrafi 2 ose 38 të LSHMAAV do të urdhërohet transmetuesi brenda një periudhe e cila nuk mund të jetë më e shkurtër se 30 (tridhjetë) ditë dhe më e gjatë se 90 (nëntëdhjetë) ditë që të harmonizojë strukturën e pronësisë me dispozitat nga ligji i njëjtë.

Nëse transmetuesi nuk vepron në përputhje me vendimin nga paragrafi 3 të këtij neni Agjencia do të heqë lejen për transmetim televiziv ose radio sipas mënyrës dhe sipas procedurës së përcaktuar në LSHMAAV.

Neni 65

Përcaktimi i koncentrit të paligjshëm mediatik, ndryshimi i strukturës së pronësisë së transmetuesve, anulimi i vendimit me të cilin lejohet zbatimi i ndryshimit të strukturës së pronësisë, iniciimin e procedurës për përcaktimin e koncentrit të paligjshëm mediatik sipas detyrës zyrtare kryhet në përputhje me dispozitat e Kapitullit IV të LSHMAAV.

XII.RITRANSMETIMI I SHËRBIMEVE PROGRAMORE NËPËRMJET RRJETIT PUBLIK TË KOMUNIKIMIT ELEKTRONIK

Neni 66

Operatori i rrjetit publik të komunikimit elektronik para fillimit me transmetim të shërbimit programor në Agjenci dorëzon aplikim për evidentim në regjistrin e operatorëve që ritransmetojnë paketa programore dhe regjistrim të shërbimeve programore që do të ritransmetohen në tërësi në formën e paketës programore.

Neni 67

Agjencia me akt nënligjor përshkruan përmbajtjen dhe formën e aplikimit dhe çertifikatës për regjistrim.

Formulari i aplikimit publikohet në ueb-faqen e Agjencisë.

Me aplikim personi përgjegjës operativ dorëzon: deklaratë me të cilën konfirmon nën përgjegjësi të plotë penale dhe materiale që për ritransmetimin e shërbimeve programore nga neni 141 paragrafi 2 nënparagrafi 3 të LSHMAAV janë respektuar të drejtat autoriale dhe të drejtat e përafërta, në përputhje me dispozitat për të drejtat autoriale dhe të drejtat e përafërta dhe kopje e noterizuar e kontratës për ritransmetim të shërbimeve programore nga neni 143 paragrafi 2 të LSHMAAV me të cilin rregullohen të drejtat autoriale dhe të drejtat e përafërta, në përputhje me dispozitat për të drejtat autoriale dhe të drejtat e përafërta.

Neni 68

Për të ndryshuar të dhënat që pëmbahen në aplikacion, operatori është i detyruar që të njoftoj Agjencinë brenda 30 (tridhjetë) ditësh pas ndryshimit të ndodhur.

Nëse kryhet ndryshim në paketën e programit, me iniciativën tuaj ose bazuar në një vendim gjyqësor të formës së prerë, operatori është i detyruar të paraqesë një deklaratë të re (neni 67 paragrafi 3 i Rregullores).

Agjencia është e detyruar brenda tri ditëve të punës nga dita e pranimit të njoftimit për ndryshimin e paketës programore të njoftoj Agjencinë për Komunikime Elektronike.

Neni 69

Nëse Agjencia në bazë të mbikëqyrjes të kryer programore në përputhje me LSHMAAV konstaton se operatori ritransmeton shërbime programore që nuk janë regjistruar në përputhje me nenin 141 të LSHMAAV, Agjencia në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga mbikëqyrja e kryer programore do të marrë aktvendim për paralajmërim të operatorit dhe urdhëron që menjëherë të ndërpresë ritransmetimin e shërbimit programor.

Për aktvendimin e marrë Agjencia do të informojë Agjencion për Komunikime Elektronike dhe zotëruesin e të drejtave autoriale dhe të drejtave të përafërta.

Aktvendimi për ndërprerjen e shërbimit programor me shpjegim të detajuar, publikohet në ueb-faqen e Agjencisë në afat prej 3 (tre) ditësh nga dita e miratimit..

Neni 70

Operatori i cili ritransmeton shërbim programor paguan kompensim vjetor për mbikëqyrjen e kryer nga Agjencia.

Kompensimin vjetor nga paragrafi 1 të këtij neni është 0,5% në total të të ardhurave vjetore të operatorit që ritransmeton shërbime programore, të realizuara me ritransmetimin e shërbimeve programore gjatë vitit të kaluar kalendarik, ose pjese të shkurtër të vitit kur operatori që ritransmeton shërbime programore fillon të sigurojë shërbime.

Operatori që ritransmeton shërbime programore është i detyruar jo më vonë se 15 mars të vitit aktual drejtuar Agjencisë të dorëzojë raport për shumën e të ardhurave totale arritur me ritransmetimin e shërbimeve programore gjatë vitit kalendarik paraardhës. Operatori që ritransmeton shërbime programore është i detyruar jo më vonë se 15 prill të vitit aktual në llogari të Agjencisë të paguaj kompensim vjetor për mbikëqyrje bazuar në raportin e paraqitur më parë për shumën e të ardhurave totale të paragrafit 3 të këtij neni, dhe paraprkishtë me aktvendim të dorëzuar dhe me faturë nga Agjencia.

Neni 71

Ritranmetimi i shërbimeve programore nëpërmjet rrjeteve të komunikimeve elektronike, procedura për evidentim në regjistrin e operatorëve që ritransmetojnë paketa programore dhe regjistrimi i shërbimeve programore në të cilin operatorët ritransmetojnë në tërësi llojin e paketës programore, kompensimin e mbikëqyrjes si dhe detyrimet e operatorit që ritransmeton shërbim programor, përshkruhen në Kapitullin VIII të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

XIII OFRUESIT E SHËRBIMEVE MEDIATIKE ME KËRKESË

Neni 72

Ofruesi i shërbimit mediatik audio ose audiovizuele është person fizik ose juridik që kryen veprimtari për ofrimin e shërbimit mediatik audio ose audioviziv dhe ka përgjegjësi redaktuese për zgjedhjen e përmbajtjes audio ose audiovizive dhe përcakton mënyrën e organizimit. Ofruesi i shërbimit mediatik audio ose audioviziv, në kuptimin e LSHMAAV, është transmetues, ose ofrues i shërbimit mediatik audioviziv me kërkesë. Person që kryen vetëm transmetim, përkatësisht distribuim të programeve audio ose audiovizive për të cilën përgjegjësi editoriale kanë vetëm persona të tretë, nuk llogaritet për ofrues i shërbimit mediatik audio ose audioviziv.

Neni 73

Ofruesi i shërbimit mediatik audioviziv me kërkesë është i detyruar para se të fillon me ofrimin e lloji të caktuar të shërbimit mediatik audioviziv me kërkesë të dorëzon aplikim për evidencë në regjistrin e ofruesve të shërbimeve mediatike me kërkesë që udhëhiqet nga Agjencia, për të cilën Agjencia jep certifikatë për regjistrim.

Nëse aplikimi nga paragrafi 1 të këtij neni nuk është i plotë, Agjencia me shkrim do të njofton parashtuesin e aplikimit për ta kompletuar dhe për ta dorëzuar në afat prej 10 (dhjetë) ditësh nga dita e pranimit të njoftimit.

Agjencia është e detyruar që vërtetimin nga paragrafi 1 të këtij neni ta jep në afat prej pesë ditë pune nga dita e pranimit të aplikimit, përkatësisht nga dita e skadimit të afatit shtesë të paragrafit 2 të këtij neni, nëse aplikimi përmban të gjitha të dhënat e nevojshme.

Neni 74

Agjencia do të fshijë ofruesin e shërbimit mediatik audioviziv me kërkesë të regjistrit, nëse:

- ofruesi i shërbimeve mediatike audioviziv me kërkesë e njofton me shkrim Agjencinë se ka ndërprerë ushtrimin e veprimtarisë,
- ofruesi i shërbimeve mediatike audioviziv me kërkesë ndërpreu ushtrimin e veprimtarisë për periudhë më të gjatë se një vit,
- ofruesi shërbimeve mediatike audioviziv me kërkesë nuk i plotëson më shumë kushtet teknike për transmetim të programeve audiovizive,

- ofruesi i shërbimeve mediatike audioviziv me kërkesë nuk ka filluar ushtrimin e veprimtarisë në afat prej tre muajsh nga data për fillimin e ofrimit të shërbimit të cekur në aplikim nga neni 73 paragrafi (2) të Rregullores,
- ofruesit të shërbimit mediatiki audioviziv me kërkesë me vendim të formës së prerë i është ndaluar ushtrimi i veprimtarisë dhe
- ofruesi i shërbimeve mediatike audioviziv me kërkesë nuk ekziston më.

Neni 75

Ofruesi i shërbimeve mediatike audioviziv me kërkesë paguan në kompensim vjetor për mbikëqyrjen e kryer nga Agjencia.

Kompensimin vjetor nga paragrafi 1 të këtij neni është 0,5% nga totali i të ardhurave vjetore të shërbimeve mediatike audiovizuele me kërkesë, realizuar nga ofrimi i shërbimeve mediatike audiovizuele me kërkesë gjatë vitit kalendarik të kaluar, ose pjese më të shkurtër të vitit kur ofruesi i shërbimeve mediatike audiovizuele me kërkesë ka filluar me ofrimin e shërbimit.

Ofruesi i shërbimeve mediatike audiovizuele është i detyruar më së voni deri më 15 mars të vitit aktual drejtuar Agjencisë të dorëzon raport mbi shumën e të ardhurave totale të realizuara nga ofrimi i shërbimeve mediatike audiovizuele me kërkesë gjatë vitit kalendarik të kaluar.

Ofruesi i shërbimeve mediatike audiovizuele me kërkesë është i detyruar më së voni deri më 15 prill të vitit aktual në llogari të Agjencisë të paguajë kompensim vjetor për mbikëqyrje bazuar në raportin paraprak të dorëzuar për shumën totale të të ardhurave nga paragrafi 3 të këtij neni, dhe me dorëzim paraprak të aktvendimit dhe faturës nga Agjencia

XIV. PLATFORMAT E NDARJES SË VIDEOVE

Neni 76

Shërbimi i platformës së ndarjes së videove është shërbim i shoqërisë së informacionit, që është destinuar për publikun e gjerë dhe ofrohet nëpërmjet rrejetit të komunikimit elektronik, qëllimi kryesor dhe/ose funksionaliteti thelbësor në tërësi dhe/ose të pjese të veçantë është që ti ofron publikut qasje në programe dhe/ose video të krijuara nga përdoruesit që kanë funksion informativ, arsimor ose argëtues, për të cilën ofruesi i shërbimit nuk ka përgjegjësi editoriale për përmbajtjet, por vetëm përcakton mënyrën se si shërbimi është organizuar përfshirë këtu mjetet automatike ose algoritme, në veçanti nëpërmjet shfaqjes, shënimit ose selektimit të përmbajtjes.

Ofruesi i shërbimit platformë për ndarjen e videove është person fizik ose juridik që ofron shërbim platformë për ndarjen e videove.

Neni 77

Ofruesi i shërbimit platformë për ndarjen e videove që është nën juridiksionin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, është i detyruar para fillimit të ushtrimit të veprimtarisë të dorëzon aplikim për evidentim në Regjistrin e ofruesve të shërbimeve platformë për ndarjen e videove që udhëhiqet nga Agjencia, për të cilën Agjencia jep certifikatë për regjistrim.

Nëse aplikimi nga paragrafi 1 të këtij neni nuk është i plotë, Agjencia me shkrim njofton parashtruesin e aplikimit për ta plotësuar dhe dorëzuar në afat prej 10 ditësh nga dita e pranimit të njoftimit.

Agjencia është e detyruar që aplikimin nga paragrafi 1 të këtij neni ta japë në afat prej pesë ditë pune nga dita e pranimit, përkatësisht nga dita e skadimit të afatit shtesë nga paragrafi 2 të këtij neni, nëse aplikimi i përmban të gjitha të dhënat e nevojshme.

Ofruesi i shërbimit platformë për ndarjen e videove është i detyruar të njofton Agjencinë për çdo ndryshim të të dhënave të cekura në aplikim në afat prej 30 ditësh nga dita e ndryshimit. Agjencia është e detyruar që të shënnon ndryshimin e të dhënave në Regjistër në afat prej tre ditë pune nga dita e pranimit të njoftimit.

Neni 78

Ofruesit e shërbimit platformë për ndarjen e videove paguajnë kompensim vjetor për mbikëqyrje në llogari të Agjencisë:

Kompensimin vjetor nga paragrafi 1 të këtij neni është 0,5% nga të ardhurat në total të ofruesit të shërbimit platformë për ndarjen e videove, realizuar nga ofrimi i shërbimit gjatë vitit kalendarik të kaluar, ose pjese më të shkurtër të vitit që kur ofruesi i shërbimit platformë për ndarjen e videove ka filluar me ofrimin e shërbimit.

Ofruesi i shërbimit platformë për ndarjen e videove është i detyruar deri më 15 mars të vitit paraparak drejtuar Agjencisë të dorëzon raport për shumën totale të të ardhurave të realizuara nga ofrimi i shërbimit gjatë vitit kalendarik të kaluar.

Ofruesi i shërbimit platformë për ndarjen e videove është i detyruar deri më 15 prill të vitit paraparak në llogari të Agjencisë të paguajë kompensimin vjetor për mbikëqyrje në bazë të raportit të dorëzuar paraparak për shumën e të ardhurave në total nga paragrafi 3 të këtij neni, me dorëzim paraparak të aktvendimi dhe faturës nga Agjencia.

Nëse ofruesi i shërbimit platformë për ndarjen e videove nuk e paguan kompensimin vjetor për mbikëqyrje, Këshilli do ta fshijë nga Regjistri i ofruesve të shërbimit për ndarjen e videove.

XV. MEDIAT ONLINE – INTERNET PORTALE

Neni 79

Person juridik ose fizik në Republikën e Maqedonisë së Veriut mund (në tekstin e mëtejshëm: RMV) të ushtron veprimtari për publikim të përmbajtjeve informative, arsimore dhe argëtuese si lloj teksti, format audio ose audioviziv nëpërmjet medias online fitimprurës ose jofitimprurës – internet portali, nëse veprimtaria është shkruar në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut (në tekstin e mëtejshëm: RQRMV), ka seli dhe redaksi në RMV dhe në emër të saj ka regjistruar internet domen mk ose mkd.

Me përjashtim nga paragrafi 1 të këtij neni, botuesit e mediave të evidentuar në regjistrin e transmetuesve si ofrues të shërbimeve mediatike për transmetim televiziv në përputhje me LSHMAAV, mund të kryejnë publikimin e përmbajtjeve informative, arsimore dhe argëtuese nëpërmjet mediave online- internet portaleve pa e shkruar veprimtarinë në RQRMV, vetën nëse kanë seli dhe redaksi në RMV dhe në emër të tyre kanë të regjistruar internet domen.mk ose mkd.

Neni 80

Botuesi i medias online – internet portali drejtuar Agjencisë dorëzon aplikim për regjistrim në regjistrin e botuesve të mediave online – internet portalit.

Në afat prej tre ditë pune nga dita e dorëzimit të aplikimit të kompletuar dhe të rregullt nga botuesi i medias online – internet portalit, Agjencia dorëzon kërkesë drejtua RQRMV për dorëzimin e gjëndjes vijuese të botuesit të medias online – internet portalit dhe Agjencisë për punësim për dorëzimin e të dhënave për numrin e të punësuarve me orar të plotë pune në botuesin e medias online – internet portalit.

Agjencia e regjistron botuesin e medias online – internet portalin në Regjistër në afat prej tre ditësh nga dita e kompletimit të dokumentacionit, nëse konstaton se i plotëson kushtet ligjore të përcaktuara në nenin 5 të LM.

Botuesi i mediave online – internet portalit është i detyruar të njofton Agjencinë për çdo ndryshim të të dhënave në afat prej shtatë ditësh nga ndryshimi i ndodhur.

XVI. MBIKËQYRJA

Neni 81

Agjencia kryen mbikëqyrje programore, administrative dhe profesionale.

Mbikëqyrja programore dhe administrative mund të jetë: mbikëqyrje e rregullt, mbikëqyrje e jashtëzakonshme dhe mbikëqyrje kontrolli.

Mbikëqyrja e rregullt kryhet në bazë të programit vjetor për kryerjen e mbikëqyrjes programore, përkatësisht administrative, dhe kur bëhet fjalë për mbikëqyrje programore dhe

në përputhje me Metodologjinë për kryerje të mbikëqyrjes programore të miratuar nga Agjencia.

Mbikëqyrje e jashtëzakonshme kryhet në bazë të iniciativës së paraqitur nga organi shtetëror, persona juridik ose fizik, si dhe në raste dyshimi sipas detyrës zyrtare të Agjencisë.

Mbikëqyrje kontrolli kryhet pas skadimit të afatit të përcaktuar në aktin e vetëm të miratuar nga Agjencia për të konstatuar nëse subjekti i mbikëqyrjes ka vepruar sipas aktit plotësisht, pjesërisht ose nuk ka vepruar.

Neni 82

Mbikëqyrje programore (monitorim) kryhet mbi programet e transmetuesve dhe ofruesve të shërbimeve mediatike audiovizuale me kërkesë, si dhe mbi paketat programore që ritransmetohen nga operatorët e rrjeteve publike të komunikimit elektronik nga aspekti i respektimit të dispozitave të LSHMAAV, lejeve, çertifikatave të dhëna për regjistrim, akteve nënligjore dhe akte të tjera të miratuara nga Agjencia.

Mbikëqyrje programore nga paragrafi 1 të këtij neni kryhet nga të punësuar në njësinë organizative të krijuara për këtë qëllim të shërbimit profesional të Agjencisë.

Për secilën mbikëqyrje të kryer programore përpilohet raport me shkrim ku i paraqitet drejtorit të Agjencisë në afat prej 3 (tre) ditësh nga dita e mbikëqyrjes së kryer programore.

Nëse mbikëqyrja e programit konstaton cënim ose shkelje, raporti me shkrim përmban dhe propozim të masës në përputhje me LSHMAAV ose ligj tjetër.

Neni 83

Mbikëqyrja administrative kryhet mbi punën e botuesve të mediave nga aspekti i harmonizimit të punës së tyre me kushtet e përcaktuara në LM dhe LSHMAAV dhe rregulloret e miratuara.

Mbikëqyrja administrative mbi punën e botuesve të mediave të shkruara zbatohet vetëm nga aspekti i harmonizimit të punës së tyre me detyrimet e përcaktuara në nenet 6, 8, 14 dhe 15 të LM.

Mbikëqyrje administrative nga paragrafi 1 të këtij neni kryhet nga të punësuarit në shërbimin profesional të Agjencisë në përputhje me aktet për sistematizimin e punëve dhe detyrave në shërbimin profesional të Agjencisë.

Për secilën mbikëqyrje administrative të kryer përpilohet raport me shkrim që i dorëzohet drejtorit të Agjencisë në afat prej 3 (tre) ditësh nga dita e kryerjes së mbikëqyrjes administrative.

Nëse mbikëqyrja administrative ka konstatuar shkelje ose cënim, raporti me shkrim gjithashtu përmban dhe propozim të masës në përputhje me LSHMAAV dhe ligj tjetër.

Neni 84

Mbikëqyrja profesionale mbi transmetuesit kryhet vetëm nga persona të punësuar në shërbimin profesional të Agjencisë, pas autorizimit paraprak nga Këshilli i Agjencisë dhe vetëm për konstatim të përmbushjes së kushteve teknike në përputhje me lejen për transmetim televiziv dhe radio.

Mbikëqyrje profesionale nga paragrafi 1 të këtij neni kryhet vetëm në afat prej 30 ditësh nga skadimi i ditës së tridhjetë nga dita e fillimit me ushtrim të veprimtarisë të përcaktuar në lejen për transmetim televiziv ose radio, si dhe gjatë ndryshimit të lokacionit në ambientet ku transmetohet programi (studio) ose kur gjatë zgjerimit me ambiente të reja për studio.

Për person i autorizuar mund të emërohet i punësuar në shërbimin profesional të Agjencisë me arsim të lartë, së paku tre vjet përvojë pune në profesion.

Personi i autorizuar pajiset me kartë identifikimi zyrtar që i shërben për të treguar aftësinë zyrtare dhe të cilën ai është i detyruar ta tregojë gjatë kryerjes së mbikëqyrjes.

Forma dhe përmbajtja e kartës zyrtare nga paragrafi 4 të këtij neni dhe mënyra e dhënies dhe marrjes janë përcaktuar në Rregulloren për formën dhe përmbajtjen e kartës zyrtare të

personit të autorizuar për kryerje të mbikëqyrjes profesionale dhe mënyrës së dhënies dhe marrjes.

XVII. MASAT NË RASTIN E SHKELJES SË RREGULLOREVE

Neni 85

Derisa konstatohet mosrespektim, cënim ose shkelje e dispozitave të LSHMAAV, LM dhe akteve nënligjore të miratuara në bazë të njëjtë, si dhe të kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara me lejen dhe akte të tjera të Agjencisë, kundër botuesi të medias, ofrues të shërbimi mediatik audioviziv me kërkesë, ofrues i shërbimit platformë për ndarjen e videove ose operatori të rrjeteve publike të komunikimeve elektronike që kryejnë ritransmetim të shërbimeve programore, Këshilli i Agjencisë ndërmerr masat e mëposhtme:

- paralajmërim publik,
- inicon procedurë për kundërvajtje në rast kur pavarësisht masës së shqiptuar paralajmërim publik nuk e ndërpren shkeljen dhe vazhdon me kryerje të shkeljes për të cilën është paralajmëruar, në afatin e përcaktuar nga Këshilli i Agjencisë, në përputhje me dispozitat e LSHMAAV.
- heqjen e lejes ose
- zbatimin e procedurës për fshirje nga regjistri i ofruesve të shërbimeve mediatike audiovizuale ose nga regjistri i transmetuesve, në përputhje me dispozitat e LSHMAAV.

Për masat e shqiptuara nga paragrafi 1, nënparagrafët 1 dhe 4 të këtij neni, Këshilli i Agjencisë miraton aktvendim përkatës. Për masa nga paragrafi 1, nënparagrafi 2, Këshilli i Agjencisë miraton propozim për iniciimin e procedurës për kundërvajtje. Për masën nga paragrafi 1 nënparagrafi 3, Këshilli i Agjencisë miraton Vendim. Kundër aktvendimit të miratuar dhe vendimi lejohet mbrojtje gjyqësore, në përputhje me nenin 24 të LSHMAAV.

Para shqiptimit të masës paralajmërim publik, Këshilli i Agjencisë do të kërkon nga botuesi i medias të deklarohet me shkrim për mosrespektim të kryer, cënim ose shkelje të dispozitave të LSHMAAV, LM dhe akteve nënligjore të miratuara në bazë të ligjit të njëjtë, si dhe të kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara në leje dhe akte të tjera të Agjencisë.

Para shqiptimit të masës nga paragrafi 1, nënparagrafët 3 dhe 4 të këtij neni, Këshilli i Agjencisë është i detyruar të siguron seancë publike në të cilën përfaqësuesi i medias do të arsyeton dhe argumenton procedurat dhe shkaqet për veprimin e medias.

Me përjashtim të dispozitave nga paragrafi 1, nënparagrafi 2 të këtij neni, nëse konstatohet mosrespektim i dispozitave të nenit 91 të LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë do të paraqesë kërkesë për iniciimin e procedurës për kundërvajtje pa marrë më parë aktvendim për paralajmërim publik.

Masat e shqiptuara nga paragrafi 1 të këtij neni janë shpjeguar detajisht, Agjencia i dorëzon me shkrim drejtuar kryesit të shkeljes në afat prej tre ditësh, llogaritur nga dita e miratimit dhe publikon në ueb-faqen e Agjencisë.

Neni 86

Masat e përcaktuara në nenin 85 paragrafi 1 nënparagrafët 1 dhe 2 të Rregullores, Këshilli i Agjencisë i shqipton sipas renditjes vijuese:

- paralajmërim publik, nëse masa shqiptohet për të parën herë në vitin aktual,
- inicon procedurë për kundërvajtje në rast se pavarësisht masës së shqiptuar paralajmërim publik në vitin aktual nuk ka ndërprerë shkeljen dhe ka vazhduar me kryerjen e shkeljes së njëjtë për të cilën është paralajmëruar.

Këshilli në Agjencia për shkeljet e konstatuara në vitin aktual, për të cilat janë shqiptuar masa në vitin e kaluar, sërish do të shqipton masë vërejtje publike sipas afateve të përcaktuara në Udhëzimin për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës.

Neni 87

Vendimet dhe aktvendimet e miratuara në rast të shkeljes së dispozitave të LSHMAAV, LM, lejet, certifikatat e dhëna për regjistrim, aktet nënligjore dhe akte të tjera të Agjencisë, janë përfundimtare.

Kundër vendime dhe aktvendimeve nga paragrafi 1 të këtij neni mund të ngrihet padi për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente.

Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të vendimit ose aktvendimit.

XVIII. MËNYRA DHE METODA E MBAJTJES SË REGJISTRAVE TË PËRCAKTUAR ME LIGJIN PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE DHE LIGJIN PËR MEDIAT

Neni 88

Agjencia në përputhje me dispozitat nga LSHMAAV është kompetente për mbajtjen e regjistrave të mëposhtëm:

- regjistrin e ofruesve të shërbimeve mediatike audiovizuele me kërkesë;
- regjistrin e transmetuesve,
- regjistrin e operatorëve që ritransmetojnë paketa programore dhe
- regjistrin e shërbimeve platformë për ndarjen e videove

Agjencia në përputhje me dispozitat e LM është kompetente të mbajë:

- regjistër të botuesve të medias së shtypit dhe
- regjistër të botuesve të mediave online - internet portalet.

XVIII.1 Regjistri i ofruesve të shërbimeve mediatike audiovizuele me kërkesë

Neni 89

Regjistri i ofruesve të shërbimeve mediatike audiovizuele me kërkesë përmban:

- firmën dhe selin qendrore, nëse ofruesi i shërbimit mediatik audioviziv me kërkesë është person juridik, përkatësisht emrin dhe mbiemrin, nëse ofruesi i shërbimit mediatik audioviziv është person fizik,
- emri dhe mbiemri i personit përgjegjës si ofrues i shërbimeve audiovizuele me kërkesë,
- mënyra se si ofrohet shërbimi,
- zona në të cilën kryhet veprimtaria,
- lloji i shërbimit dhe përshkrimi i shkurtër i tij dhe
- data e fillimit të ofrimit të shërbimit, si dhe çdo ndryshim i kryer në ofrimin e shërbimit,

Forma dhe përmbajtja e regjistrit nga paragrafi 1 të këtij neni të përcaktuara nga Agjencia.

Në rast të ndryshimit të të dhënave në regjistrin nga paragrafi 1 të këtij neni Agjencia menjëherë ose më së voni në afati prej 3 (tre) ditësh nga dita e pranimi të njoftimit nga ofruesi i shërbimeve mediatike audiovizuele me kërkesë për ndryshim të të dhënave, do të evidentojë ndryshimin e të dhënave në regjistër.

XVIII.2 Regjistri i transmetuesve

Neni 90

Regjistri i transmetuesve në Republikën e Maqedonisë së Veriut përmban:

- firmën dhe selin qendrore, si dhe emri dhe mbiemri i personit përgjegjës të transmetuesit
- emri dhe mbiemri i redaktorit përgjegjës,
- adresa e redaksisë dhe adresa e redaktorit përgjegjës,
- mënyra e transmetimit të shërbimit programor (radiofrekuenca, multipleksi digjital tokësor, satelit ose rrjeti publik i komunikimit elektronik),
- niveli i shikueshmërisë/dëgjueshmërisë (shtetëror, rajonal ose lokal),
- zona/zonat në të cilat do të ushtrohet veprimtaria,

- zona e shërbimit dhe lokacioni i mjetit teknik për transmetim, nëse bëhet fjalë për transmetim analog tokësor,
- shenjë identifikimi dhe
- koncepti programor.

Forma dhe përmbajtja e regjistrit nga paragrafi 1 të këtij neni përcaktohet nga Agjencia.

Në rast të ndryshimi në të dhënat në regjistrin nga paragrafi 1 të këtij neni Agjencia menjëherë ose më së voni në afat prej 3 (tre) ditësh nga dita e pranimit të njoftimit nga transmetuesi për ndryshimin e të dhënave, do ta evidenton ndryshimin e të dhënave në regjistrin.

XVIII.3 Regjistri i operatorëve që ritransmetojnë paketa programore

Neni 91

Regjistri i operatorëve që ritransmetojnë paketa programore përmban:

- emri dhe adresa e operatorit,
- emri dhe mbiemri i personit përgjegjës të operatorit,
- paketa programore përkatësisht lista e shërbimeve programore për të cilin operatori ka të rregulluar të drejtën autoriale dhe të drejtat e përafërta për ritransmetimin e tyre dhe
- zonë në të cilën operatori do t'i ritransmeton shërbimet programore (zona e shërbimit).

Forma dhe përmbajtja e regjistrit nga paragrafi 1 të këtij neni përcaktohet nga Agjencia.

Në rast të ndryshimit të të dhënave në regjistrin nga paragrafi 1 të këtij neni Agjencia menjëherë ose më së voni në afat prej 3 (tre) ditësh nga dita e pranimit të njoftimit nga operatori për ndryshimin e të dhënave, do ta evidenton ndryshimin e të dhënave në regjistrin.

XVIII. 4 Regjistri i shërbimeve të platformës për ndarjen e videove

Neni 92

Regjistri i ofruesit të shërbimeve të platformës për ndarjen e videove përmban të dhënat në vijim:

- emri i plotë i personit juridik,
- selia e personit juridik,
- personi përgjegjës
- të dhëna për pronarin,
- emërin e platformës për ndarje videove,
- adresa elektronik e personit përgjegjës dhe ligjor.

Forma dhe përmbajtja e regjistrit nga paragrafi 1 të këtij neni të përcaktuar nga Agjencia.

Në rast të ndryshimit të të dhënave në regjistrin nga paragrafi 1 të këtij neni Agjencia menjëherë ose më së voni në afat prej 3 (tre) ditësh nga dita e pranimit të njoftimit nga ofruesi i shërbimit të platformës për ndarjen e videove për ndryshim të të dhënave, do ta evidentojë ndryshimin e të dhënave në regjistrin.

XVIII.5.Regjistri i botuesve të mediave të shtypit

Neni 93

Regjistri i botuesve të mediave të shtypit:

- firma dhe selia qendrore përkatësisht, emri dhe adresa e botuesi të medias së shtypit,
- emri dhe mbiemri i personit përgjegjës të botuesit të medias së shtypit dhe
- emri i gazetës ose revistës.

Të dhënat nga paragrafi 1 të këtij neni Agjencia i merr nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut, që është i detyruar në afat prej pesë ditësh nga dita e kryerjes së regjistrimit të njëjtat, pa pagesë t'i dorëzoj .

Në rast të ndryshimit të të dhënave në regjistrin nga paragrafi 1 të këtij neni Agjencia menjëherë ose më së voni në afat prej 3 (tre) ditësh nga dita e pranimi të njoftimit nga botuesi i medias së shtypit për ndryshim të të dhënave, do ta evidenton ndryshimin në regjistër.

XVIII.6. Regjistri i mediave online – internet portalet

Neni 94

Regjistri i botuesve të mediave online – internet portalet udhëhiqet në formë elektronike dhe përmban të dhëna për:

- firmën dhe vendin përkatësisht emrin dhe adresë të botuesit të medias online – internet portalit,
- emri dhe mbiemri i personit përgjegjës të botuesit të medias online – internet portalit,
- emri i medias online – internet portalit,
- adresa e internetit të medias online – internet portalit, dhe
- regjistruesi i domenit të internetit maqedonas .mk ose .mkd

Forma dhe përmbajtja e regjistrin nga paragrafi 1 të këtij neni të përcaktuara nga Agjencia.

Në rast të ndryshimit të të dhënave në regjistrin nga paragrafi 1 të këtij neni Agjencia menjëherë ose më së voni në afat prej 3 (tre) ditësh nga dita e pranimi të njoftimit nga botuesi i medias online – internet portalit për ndryshim të të dhënave, do ta evidentojë ndryshimin e të dhënave në regjistër.

Neni 95

Agjencia në ueb-faqen e saj i publikon të dhënat nga regjistrat për nenet 89, 90, 91, 92, 93 dhe 94 të Rregullores, duke marrë parasysh mbrojtjen e të dhënave personale.

XIX. DISPOZITA TË TJERA ME RËNDËSI PËR FUNKSIONIMIN E AGJENCISË

XIX. 1. Akte të përgjithshme për punën e Agjencisë

Neni 96

Puna aktuale e Agjencisë është e rregulluar me akte nënligjore që i referohen kohëzgjatjes së pushimeve vjetore të të punësuarve në Agjencion; shfrytëzimi, menaxhimi dhe mirëmbajtja e automjeteve zyrtare të Agjencisë; përdorimi i telefonave zyrtar mobil; forma dhe përmbajtja e kartës së identifikimit zyrtar të personit të autorizuar për kryerjen e mbikëqyrjes profesionale dhe mënyra e dhënies së saj; zhvillimin profesional të të punësuarve në shërbimin profesional të Agjencisë; ofrimi i transparencës së punës së Agjencisë; mjete për përfaqësim; ruajtje dhe fshirjen e regjistrimeve në shërbimet televizive dhe radio; siguri sekreti dhe mbrojtja në përpunimin e të dhënave personale; dhënia e kopjeve nga regjistrim i informacioni të publikuar në programin e transmetuesit; siguria dhe shëndeti në punë; detyrat dhe përgjegjësi të administratorit të sistemit të informacionit dhe të personave të autorizuar në Agjencion; kryerje të video mbikëqyrjes; rendin e punës dhe përgjegjësi disiplinore dhe materiale të të punësuarve në Agjencion; veshja zyrtare e të punësuarve dhe çështje të tjera me rëndësi për punën në vijim të Agjencisë.

XIX . 2. Informacion i klasifikuar

Neni 97

Informacione në lidhje me: të dhënat personale zbulimi i të cilëve do të thoshte cënim i mbrojtjes së të dhënave personale; informacion i fituar ose i përpiluar për hetim, procedurë penale ose për kundërvajtje, zbatimin e procedurës administrative dhe civile, dhënia e së cilës do të kishte pasoja të dëmshme gjatë procedurës; informacioni që i referohen interesave komerciale dhe ekonomike; informacion për dokument që është në procedurë të përgatitjes dhe ende është lëndë për harmonizim të poseduesi i informacionit, zbulimi i të cilit do të shkakton kuptim të gabuar të përmbajtjes dhe të ngjajshme, shënohen me shenjë "për përdorim të kufizuar",

Informacioni e cila është klasifikuar me shenjë " për përdorim të kufizuar " shënohet si e tillë në vend të dukshëm.

Personit të cilit i është dorëzuar informacion / material me shenjë " për përdorim të kufizuar", nuk duhet përmbajtjen e tyre të zbulon personave të tjerë deri në momentin e deklasifikimi në informacioni / material.

Klasifikimi, përkatësisht deklasifikim i informacionit kryhet nga drejtori i Agjencisë, në përputhje me ligjet pozitive rregulloret në Republikën e Maqedonisë së Veriut që e përcakton kjo materie, për çfarë e informon Këshillin e Agjencisë.

Me deklasifikim kryhet ndryshim nga informacion i klasifikuar në informacion për të cilin kemi qasje të lirë dhe për këtë njoftohen përdoruesit e informacionit.

XIX. Trupat e punës

Neni 98

Për shqyrtimin dhe përcaktimin e qëndrimeve për çështje në kompetencë të Agjencisë, për dhënie të mendimit dhe përgatitjen e propozimeve për zgjidhjen e çështjeve të caktuara, Agjencia mund të krijojë grupe pune si (komisione, grupe, ekipe, dhe të ngjajshme).

Organet punuese të Agjencisë mund të krijohen si organ të përhershëm ose të përkohshëm.

Me aktin për themelimin e trupit punues nga paragrafi 1 të këtij neni, Agjencia përcakton detyrat e tyre, mënyrën e punës dhe përbërjen.

Neni 99

Për përgatitjen e materialeve të veçanta profesionale, Këshilli i Agjencisë përkatësisht drejtori i Agjencisë mund të angazhon persona profesional- nga fusha të ndara.

XIX. 4 Bashkëpunimi

Neni 100

Agjencia në punën e saj duhet të marrë parasysh direktivat e Bashkimit Evropian, aktet e Këshillit të Evropës, konventat ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Maqedonisë së Veriut, si dhe përvojën e shteteve anëtare të Unionit Evropian.

Neni 101

Agjencia është e detyruar të bashkëpunon, jep mendime, propozime dhe shkëmbim të të dhënave me Ministrinë për transformim digjital, Agjencinë për komunikime elektronike, Komisioni për mbrojtjen e konkurrencës, Komision shtetëror për parandalim të korrupsionit, Agjencia për mbrojtje të të dhënave personale, Komisioni shtetëror zgjedhor, Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut, organi kompetent për mbrojtjen e të drejtave autoriale dhe të drejtat e përafërta dhe organe të tjera shtetërore, organe të administratës shtetërore, ndërmarrje publike, njësi të vetëqeverisjes lokale, institucione publike dhe institucione nga Republika e Maqedonisë së Veriut.

Gjatë shkëmbimit të të dhënave Agjencia është e detyruar të siguroj besueshmëri në të njëjtit në përputhje me ligjin.

Neni 102

Agjencia është e detyruar të bashkëpunon dhe shkëmben informacion me Inspektoratin shtetëror të tregut, organin kompetent për mbrojtjen e të drejtave autoriale dhe të drejtat e përafërta dhe organe të tjera kompetent dhe trupa me qëllim të sigurojë mbrojtje ligjore të

shërbimeve që kanë qasje të kushtëzuar, si dhe në parandalim të mundësisë për përdorim të pajisjeve të paautorizuara që mundësojnë qasje në përputhje me ligjin.

Neni 103

Agjencia në përputhje me kompetencat e saj, dhe në drejtim të zbatimit të dispozitave nga LSHMAAV, bashkëpunon me organe rregullatore nga vende të tjera dhe institucione ndërkombëtare.

Neni 104

Agjencia mund të nënshkruaj memorandum bashkëpunimi me organe, trupa dhe institucione nga neni 99 të RRegullores, me këto memorandume detajisht do të përcaktohet bashkëpunimi, si dhe mënyra dhe procedura për shkëmbim të të dhënave dhe informacione që janë të nevojshme për ushtrimin e kompetencave të saj.

XIX.5 Shërbimi profesional i Agjencisë

Neni 105

Agjencia ka shërbim profesional që i kryen punët profesionale, normative-juridike, administrative, administrative-mbikëqyrëse, materiale-financiare, kontabilitet, IT dhe punë të tjera të Agjencisë.

Organizimi i brendshëm, fushëveprim i punës dhe kushtet për punësim në shërbimin profesional të Agjencisë më afër rregullohen me aktet për organizim të brendshëm dhe sistematizim të punës dhe detyrave, në përputhje me Ligjin për marrëdhënie pune,

Në përbërjen e shërbimit profesional të Agjencisë detyrimisht ekziston njësi organizative njësi për kryerje të mbikëqyrjes programore (monitorim) të programeve që transmetohen nga radiodifuzerët, ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizuale me kërkesë dhe paketat programore të operatorëve të rrjeteve publike të komunikimit elektronik që ritransmetojnë shërbim programor nga aspekti i respektimit të dispozitave të ligjit, akteve nënligjore dhe akte të tjera të Agjencisë, lejet dhe çertifikatat e dhëna për regjistrim, në përputhje me planin vjetor për kryerjen e mbikëqyrjes programore dhe Metodologjisë për kryerjen e mbikëqyrjes programore të përcaktuar nga Agjencia me akte nënligjore.

Neni 106

Shërbimi profesional kryen punë brenda kompetencës së tij në mënyrë të pavarur dhe të paanshme, duke iu përmbajtur procedurave të përcaktuara në LSHMAAV, rregulloret të miratuara në bazë të ligjit dhe akteve interne të Agjencisë,

Të punësuarit në shërbimin profesional, detyrat e punës i kryejnë në përputhje me aktet për organizim të brendshëm dhe sistematizim në të cilën përcaktohet mënyra e punës, kompetencat dhe udhëheqja me format organizativ.

Delegimi i detyrave të punës, kryehet nga drejtori i Agjencisë/udhëheqësit e drejtpërdrejtë, dhe atë;

- drejtori i Agjencisë – udhëheqësve të sektorëve/udhëheqës shërbimi;
- udhëheqës sektori – udhëheqës njësie, dhe
- udhëheqës njësie – bashkëpunëtorë të lartë, bashkëpunëtorë, bashkëpunëtorë të rinj, referent i lartë, referent, domart, punëtor në kuzhinë, shofer-furnizues shpërndarës, punëtor në sportel.

Të punësuarit në shërbimin profesional është i detyruar të refuzon urdhër për të vepruar në kundërshtim me LSHMAAV, rregulloret e miratuara në bazë të ligjit, si dhe akte të tjera të Agjencisë edhe kur një urdhër i tillë vjen nga epror dhe për këtë të njoftohet drejtori, kryetari dhe anëtarët e Këshillit.

Neni 107

Sjellja e të punësuarve në shërbimin profesional të Agjencisë gjatë kryerjes së kompetencave të përcaktuara në LSHMAAV, rregullat e miratuara në bazë të ligjit dhe akte të tjera të Agjencisë nga afër rregullohen me Kodin e sjelljes të punësuarve në shërbimin profesional që e miraton Agjencia dhe publikon në ueb-faqen e Agjencisë.

XX. DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 108

Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit, dhe do të publikohet në tabelën e njoftimeve të Agjencisë dhe ueb-faqe të Agjencisë.

Me hyrjen në fuqi të Rregullores pushon së vlefshmi Rregullorja e punës së Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele nr.01-4351/1 datë 29.8.2014 dhe Rregulloren e Punës nr. 01-2949/1 datë 30.5.2019, për ndryshim dhe plotësim të Rregullores së Punës së Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuele
Kryetari i Këshillit,
Mr. Sasho Stefanovski**